

Rritja e rolit të Parlamentit në procesin e integritimit përmes pjesëmarrjes legislative dhe transparencës

Buletin informativ Nr.1

Dhjetor 2011

DITMIR BUSHATI

Kryetar i Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian

Kam privilegjin që nën cilësinë e kryetarit të Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian të përshendes botimin e këtij buletini informativ që vjen për lexuesin në kuadër të projektit që zbatohet nga Qendra e Studimeve Parlamentare mbi “Rolin e Kuvendit në procesin e Integritimit Europian”.

Kjo iniciativë e Qendrës së Studimeve Parlamentare i shërben jo vetëm fuqizimit të veprimtarisë mbikqyrëse të strukturave parlamentare në procesin e integritimit europian të Shqipërisë, por edhe bashkëpunimit të strukturave parlamentare me shoqërinë civile, për të mundësuar një komunikim sa më mirë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ky proces.

Një ndër elementet thelbësore të procesit të zgjerimit është padyshim komunikimi me grupet e ndryshme të interesit, të cilët duhet të marrin informacionin e nevojshëm për sfidat me të cilat ato duhet të përballen në të ardhmen. Praktika tregon se një shoqëri e informuar ka pritshmëri realiste në lidhje me procesin e integritimit europian.

Komisioni Parlamentar i Integritimit Europian posaçërisht ka një rol të rëndësishëm në këtë proces. Përmes aktivitetit ligjvënës, kontrollues dhe bashkëpunues me grupe të ndryshme ai bën që axhenda e integritimit europian të ngjizet si një axhendë zhvillimi e transformimi demokratik dhe shoqëror.

Duhet theksuar gjithashtu se roli i Kuvendit mbetet vendimtar edhe përsa i përket ushtrimit të kontrollit parlamentar ndaj politikave të ekzekutivit dhe institucioneve të tjera, sikundër përmirësimit të cilësisë së ligjbërjes dhe konsultimit me grupet e interesit, çka rrit koeficientin demoraktik në politikëbërje.

Është kjo arsyeja që përmirësimi dhe konsolidimi i jetës parlamentare përbën një ndër prioritetet kryesore të Opinioneve të Komisionit Europian në lidhje me aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Vështruar nga ky prizëm, shpreh bindjen se ky buletin informativ do të jetë një vlerë e shtuar në përcjelljen e informacionit rreth ecurisë së procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*. Ky buletin vjen në një moment të rëndësishëm për fatin europian të Shqipërisë. Në të njëjtën kohë ai do ta sjellë më afër veprimtarinë e Kuvendit me qytetarin, duke pasqyruar e analizuar gamën e shumëllojshme të çështjeve që kanë të bëjnë me ecurinë e vendit tonë në procesin e integritimit europian.

Në këtë numër:

1. Analiza ligjore: Kuadri ligjor ekzistues mbi rolin e Kuvendit në procesin e Integritimit si dhe detyrat e Komisionit Parlamentar të Integritimit Europian
Erion Fejzulla
faqe2-3
2. Avokati i Popullit (Ombudsmani) Europian dhe Parlamenti Europian
Taulant Troshani
faqe4-9
3. Neni 68 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe përafrimi i legjislacionit Europian
Denis Gila
faqe9-13
4. Raport për veprimtarinë e Komisionit të Integritimit Europian
Shtator – Nëntor 2011
Denis Gila
faqe13-17
5. Raport i monitorimit të veprimtarisë së Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian dhe punimeve të Kuvendit në seancë plenare
6 Tetor – 30 Nëntor 2011
faqe 17-20
6. Kalendar i punimeve të Kuvendit
faqe 1,20-21

KALENDAR I

SEANCË PLENARE

E Enjte, datë 15 dhjetor 2011, ora 10.00.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare.
2. Projektligj “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.

(vijon në faqen 20)

Mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros.
Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Analiza ligjore: Kuadri ligjor ekzistues mbi rolin e Kuvendit në procesin e Integrimit si dhe detyrat e Komisionit Parlamentar të Integrimit Evropian

Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon se “Shqipëria është republikë parlamentare” duke përcaktuar konturet e sistemit të qeverisjes së vendit dhe duke garantuar gjithashtu balancimin dhe ndarjen ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Të gjithë pushtetet janë njësoj të rëndësishëm dhe të ngarkuar me një sërë detyrash dhe kompetencash të nevojshme për mirëqeverisjen e vendit.

Përveç funksionit legjislativ Kuvendi gëzon edhe një sërë kompetencash të tjera të përshkruara kryesisht në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit, si edhe në ligje të tjera të veçanta, të cilat lidhen kryesisht me emërimet në struktura të larta të shtetit duke përfshirë dhe sistemin e drejtësisë apo monitorimin dhe kontrollimin e pushtetit të ushtruar nga ana e qeverisë dhe institucioneve të tjera shtetërore.

Si përfaqësues i drejtpërdrejtë i vullnetit të popullit Kuvendi luan një rol të rëndësishëm në materializimin e të gjithë atyre nismave të cilat lidhen drejtpërdrejtë me prosperitetin dhe zhvillimin e shtetit dhe shoqërisë shqiptare. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme të analizohet roli i Kuvendit në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë proces i cili përmban pa dyshim një nga objektivat më madhor të shoqërisë shqiptare.

Përfshirja e Kuvendit në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë daton qysh me fillimet e këtij procesi dhe më konkretisht me përfshirjen e Shqipërisë në Procesin e Stabilizim Asocimit. Roli i Kuvendit në këtë proces ka ardhur në rritje dhe ai është intensifikuar me avancimin e hapave të Shqipërisë drejt integrimit evropian që nga përfshirja në PSA, miratimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, procesi i liberalizimit të vizave dhe deri në ditët e sotme kur diskutohet rreth sfidave të kandidimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Përveç përcjelljes së mesazheve politike nëpërmjet rezolutave apo deklarimeve të vazhdueshme që ritheksojnë vullnetin e ligjvënësve për integrimin evropian të Shqipërisë sa herë këtë e kanë diktuar rrethanat politike apo momentet e rëndësishme të integrimit, në mënyrë të vazhdueshme janë ndërmarrë reforma institucionale dhe ligjore për të përcaktuar më qartë rolin e Kuvendit në këtë proces.

Përfshirja dhe roli i Kuvendit në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë është bërë me mënyra të ndryshme të cilat mund të përmbledhen më shumë sesa në rend kronologjik në një rend logjik që demonstroi dhe zhvillimet e vendit tonë në këtë drejtim.

Së pari, përfshirja e Shqipërisë në PSA dhe intensifikimi i marrëdhënieve me BE-në solli si domosdoshmëri krijimin e strukturave të posaçme në nivel ekzekutiv duke mos lënë pa prekur edhe Kuvendin e Shqipërisë. Kështu në vitin 2002 me vendim të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 37, datë 16 maj 2002, u krijua një komision i posaçëm parlamentar për “Integrimin Evropian dhe Paktin e Stabilitetit”. Duhet theksuar që Pakti i Stabilitetit dhe PSA ishin dy procese komplementare me njëra tjetrën që merrnin përsipër orientimin e vendeve të rajonit ballkanik për t’iu përgjigjur perspektivës evropiane me një mbështetje të gjerë të ofruar jo vetëm nga BE por edhe nga organizata të tjera ndërkombëtare apo shtete të tjera si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët ishin drejtpërdrejtë të

interesuar për zhvillimin e rajonit.

Ky Komision i cili u ngrit me propozimin e Komisionit të përhershëm për Politikën e Jashtme kishte në përbërjen e tij edhe anëtarë nga komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit gjashtë nga të cilët u përcaktuan nominalisht. Vendimi nuk përcaktonte kohëzgjatjen e Komisionit por ia linte atë zhvillimeve dhe nevojave të procesit të integrimit evropian. Ky Komision në bazë të këtij vendimi do të realizonte përfshirjen e Kuvendit në këto procese nëpërmjet nxitjes dhe garantimit të zbatimit të instrumenteve të ofruara nga Pakti i Stabilitetit apo PSA, koordinimin e politikave në nivel komisionesh parlamentare dhe në bashkëpunimin me institucionet e tjera duke përfshirë këtu Këshillin e Ministrave, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian, forcimin e bashkëpunimit me strukturat homologe të rajonit dhe më gjerë, dhe përfshirjen në çështjet që ishin të përbashkëta për rajonin si krimi i organizuar, trafikimi, korrupsioni e të tjera dhe çka është më e rëndësishmja garantimin e një transparence të plotë për publikun dhe përfshirjen e grupeve të interesit lidhur me procesin e integrimit dhe përmbushjen e detyrimeve si nga ana e Qeverisë dhe ajo e Kuvendit.

Megjithëse Vendimi Nr. 37 nuk parashikonte se cila forcë politike do të drejtonte këtë komision që në fillim u vendos që kryetari i këtij komisioni ti jepej opozitës dhe kjo praktikë është ruajtur deri më sot. Në vitin 2004, me miratimin e Rregullores së re të Kuvendit, Komisioni për Integrimin Evropian dhe Paktin e Stabilitetit u shndërrua në Komision të përhershëm për Integrimin Evropian (KIE). Me një filozofi tjetër, KIE ndryshe nga para-ardhësi i tij nuk ka detyrimisht në përbërjen e vetë anëtarë nga gjithë komisionet e tjera. Si gjithë komisionet parlamentare, KIE ka një përbërje që reflekton në një masë të madhe përbërjen e Kuvendit. Megjithatë, edhe pse shumica e anëtarëve janë vetëm anëtarë të KIE-së, tre nga anëtarët u përkasin gjithashtu edhe disa komisioneve të tjera parlamentare. Të dy format e përbërjes së Komisionit të Integrimit Evropian janë të njohura në vendet e BE-së. Secila ka përparësitë dhe mangësitë e veta. Megjithatë, ajo që vihet re dhe që është e rëndësishme për tu theksuar si për Komisionet e Integrimit Evropian apo për Komisionet e Çështjeve të BE-së janë kompetencat e gjera që këto Komisione kanë. Kryesisht, këto kompetenca rrisin pushtetin e Parlamentit në procesin e integrimit dhe kanë të bëjnë me kërkimin e informacionit të detajuar nga Qeveria jo vetëm për procesin e integrimit të tërësi, por edhe për ta detyruar qeverinë që të mbajë një qëndrim të caktuar mbi çështje të caktuara të BE-së. Këto kompetenca janë rregulluar jo vetëm në Rregulloret e Parlamenteve të vendeve të BE-së, por në disa raste edhe në Kushtetutat e tyre. Kështu, për shembull, Kushtetutat e Austrisë dhe Finlandës u ndryshuan para anëtarësimit të këtyre vendeve në BE për t’i dhënë një zë më të fortë Parlamentit në çështjet e BE-së, për të detyruar Qeverinë që të japë llogari dhe informacion periodik Kuvendit si dhe të ndjekë opinionet detyruese të Parlamentit në çështje të caktuara të BE-së.

Rregullimet ligjore aktuale për rolin e Komisionit të

(vijon në faqen 3)

Analiza ligjore: Kuadri ligjor ekzistues mbi rolin e Kuvendit në procesin e Integrimit si dhe detyrat e Komisionit Parlamentar të Integrimit Evropian

(vijon nga faqja 2)

Integrimit Evropian janë të vagëta dhe të përgjithshme. Ndryshe nga lista e hollësishme e kompetencave të ish komisionit *ad hoc*, në nenin 19 të Rregullores së Kuvendit, fusha e KIE-së përcaktohet vetëm si “integrimi në Bashkimin Evropian”. Përveç këtij përcaktimi të përgjithshëm, në nenin 68 të Rregullores, KIE ngarkohet edhe me kontrollimin e harmonizimit të legjislacionit të propozuar me legjislacionin e BE-së.

Megjithatë roli i Kuvendit në procesin e integrimit nuk kufizohet vetëm tek rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Parlamentar të Integrimit. Një tjetër akt ligjor mbi rolin e Kuvendit në fushën e integrimit evropian është edhe Ligji nr. 9252, datë 8 korrik 2004 “Për punën e Kuvendit në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. I prezantuar nga kryetari i atëhershëm i Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë, deputeti i PS-së Ilir Zela (shpesh ligji referohet me emrin ‘ligji Zela’), ligji synon “vendosjen e rregullave të posaçme për rolin që duhet të luajë dhe punën që duhet të bëjë Kuvendi si organi më i lartë ligjvënës në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit, me qëllim hartimin e një kuadri të plotë ligjor, mbështetjen dhe mbikëqyrjen e procesit të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian”. Kështu ligji parashikon se Kuvendi duhet të “ndjek dhe mbikëqyr Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit, i cili realizohet nëpërmjet dialogut politik, negociimeve dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit, Programit CARDS dhe instrumenteve të tjera për koordinimin e përpjekjeve dhe vlerësimin e arritjeve në drejtim të qëllimit të përbashkët” (neni 2). Ligji ngarkon gjithashtu Këshillin e Ministrave me një sërë përgjegjësisish që kanë të bëjnë me informimin e Kuvendit në lidhje me punën e bërë pranë institucioneve të ndryshme të BE-së. Gjithashtu në këtë ligj trajtohet dhe roli i Kuvendit në funksionin e tij mbikëqyrës dhe kontributin e tij në procesin e integrimit si edhe nxitjes së bashkëpunimit me ekzekutivin për këto çështje. Ligji kërkon opinionin e detyrueshëm të KIE-s “në çdo rast”, ndërsa komisionet e tjera konsultohen “sipas fushës së veprimtarisë së tyre”. Ligji kërkon edhe që raportet e paraqitura pranë KIE-s të shërbejnë si bazë për shqyrtimet që do të bëhen nga të gjitha komisionet e Kuvendit sipas fushave të veprimtarisë së tyre dhe që Kuvendi të kryejë një vlerësim vjetor gjithëpërfshirës të ecurisë së Shqipërisë në procesin e përafritimit me BE-në, duke zhvilluar edhe një debat në seancë plenare. Neni 7 kërkon që Kuvendi të ketë arkivin e tij me “një dokumentacion të plotë dhe të detajuar për Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian”, në dispozicion të të gjithë deputetëve, duke parashikuar, gjithashtu, që edhe Ministria e Punëve të Jashtme t’i vërë në dispozicion Kuvendit informacionin e marrë në Bruksel dhe atë që ka të bëjë me progresin e Shqipërisë, duke përcaktuar më tej se deputetët e KIE-s dhe ata të Komisionit të Politikave të Jashtme kanë të drejtë të marrin publikimet zyrtare të BE-së që u nevojiten për të ushtruar mandatin e tyre. Ndërkohë që ligji gjithashtu kërkon që Këshilli i Ministrave t’i paraqesë një raport të përvitshëm Kuvendit gjatë dy muajve të parë të vitit në vijim mbi ecurinë

e marrëdhënieve BE - Shqipëri gjatë vitit paraardhës.

Edhe pse i hartuar me një frymë të ngjashme me kompetencat e Parlamenteve të shumë vendeve anëtare, duke marrë në konsideratë edhe kohën kur është hartuar (viti 2004 ka qenë viti i zgjerimit më të madh të BE-së dhe me shumë gjasa hartuesi i ligjit i është referuar tendencës së evropianizimit të parlamenteve të vendeve të reja anëtare të BE-së), rëndësia dhe zbatimi i ligjit ‘Zela’, madje edhe vetë ekzistenca e tij janë vënë shpesh në diskutim. Kanë qenë të pakta rastet kur ky ligj ka shërbyer si bazë për veprimet e parlamentit në funksion të procesit të integrimit. Shpesh janë përdorur mekanizma të tjerë përtej atyre të parashikuar në ligj. Do të kishte qenë e udhës që këto mekanizma të përshtateshin me mirë në funksion të përbushjes së të drejtave dhe detyrave që ka Kuvendi ashtu sikurse përcaktohen në ligjin ‘Zela’.

Megjithatë, duhet pasur parasysh që ai ligj është ende në fuqi dhe se ai është tregues i përpjekjes për të filluar procesin e evropianizimit të Kuvendit të Shqipërisë. Ky proces, ashtu si edhe në vendet e tjera anëtare të BE-së, synon që Kuvendi, si përfaqësues i drejtëpërdrejtë i vullnetit të popullit të ketë kompetenca me të forta dhe me të qarta në procesin e integrimit evropian.

Një tjetër moment i rëndësishëm mbi rolin e Kuvendit në procesin e integrimit është pjesëmarrja e tij në Komitetin Parlamentar për Stabilizim Asociimin (KPSA). KPSA është krijuar nga MSA (neni 122) si një forum i Anëtarëve të Kuvendit Shqiptar dhe Parlamentit Evropian për të diskutuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre. KPSA përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Evropian, nga njëra anë, dhe anëtarë të Kuvendit shqiptar, nga ana tjetër. Pjesa më e madhe e anëtarëve që përfaqësojnë Kuvendin shqiptar në KPSA përbëhet nga anëtarë të KIE-s. Ky është edhe një hap i parë dhe i rëndësishëm drejt komunikimit direkt mes parlamentit të një vendi aspirant dhe Parlamentit Evropian.

Në përfundim, mund të themi se roli i Kuvendit në procesin e integrimit të Shqipërisë në BE është shumë i rëndësishëm. Risitë dhe impakti që sjell procesi i integrimit evropian mbi parlamentet e vendeve anëtare dhe kandidate apo aspirant janë një fakt i njohur nga këto parlamente dhe i vlerësuar pozitivisht. Prosesi i evropianizimit të parlamenteve nacionale ka synuar gjithmonë rritjen e rolit të tyre në procesin e integrimit evropian dhe në formulimin dhe zbatimin e politikave dhe menaxhimin e çështjeve të BE-së. Ky proces nuk ka lindur vetëm si nevojë e parlamenteve të vendeve anëtare për të ngritur zërin e tyre në çështjet e BE-së, por së fundmi edhe me nismën e vetë BE-së. Jo pa qëllim, ndryshimet e fundit të sjella nga Traktati i Lisbonës iu njohin parlamenteve të vendeve anëtare një rol më të madh në procesin e politikbërjes në BE, një rol të përcaktuar qartë dhe të dallueshëm nga ai i qeverive të vendeve anëtare. Ky zhvillim i ri ka bërë që shumë vende anëtare të rishikojnë kuadrin rregullator mbi të cilat funksionojnë parlamentet e këtyre vendeve me qëllim që të bëjnë të zbatueshme risitë e Traktatit të Lisbonës. Kjo është edhe rruga në të cilën duhet të eci Kuvendi i Shqipërisë në reformimin e kuadrit të vet rregullator dhe institucional.

Erion Fejzulla

Avokati i Popullit (Ombudsmani) European dhe Parlamenti European

OMBUDSMANI EUROPIAN, NJE OMBUDSMAN PARLAMENTAR

Ombudsmani european u themelua në vitin 1992 nga Traktati i Maastrichtit, që ka hyrë në fuqi në 1993, ku nuk bëhej fjalë për një institucion, por për një organ të Bashkimit European. Ky organ është modeluar mbi bazën e kompetencave të Ombudsmanëve kombëtarë. Është një institucion i hershëm i inspiruar nga praktika suedeze, që shërben si ndërmjetës për të gjetur një zgjidhje me pëlqimin e të dyja palëve. Ombudsmani european e ka origjinën nga vendet nordike, pastaj është adoptuar edhe nga shumë vende të tjera, në Francë është adoptuar në vitin 1973.

Ombudsmani i parë european është zgjedhur në vitin 1995 dhe është një organ, që në aktivitetin e tij ka njohur një sukses të madh. Veprimtarinë e vet ai e zhvillon në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Parlamentin European, por edhe me tërësinë e institucioneve të Bashkimit European. Ombudsmani aktual, që është rizgjedhur në vitin 2010 është me shtetësi greke dhe quhet z.Nikiforos Diamandouros.¹ Kushtet, që duhet të përmbushin kandidatët për postin e Ombudsmanit european janë: të jenë qytetarë të BE-së dhe të gëzojnë në mënyrë të plotë të drejtat e tyre civile dhe politike. Për më tepër, kandidatët duhet të ofrojnë garanci, që do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në pavarësi të plotë dhe të përmbushin kushtet e nevojshme, në vendet e tyre përkatëse për ushtrimin e funksioneve më të larta juridiksionale, të kenë eksperiencë dhe të jenë kompetentë për përmbushjen e funksioneve të Ombudsmanit european.²

Dispozitat relative me Ombudsmanin european në të drejtën e Bashkimit European i gjejmë në nenin 20 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, që i referohet nocionit të qytetarit të Bashkimit European, duke i përcaktuar edhe natyrën e tij. Paragrafi 2 parashtrohet të drejtat, që gëzojnë qytetarët e Bashkimit European. Ndërmjet të drejtave të parashikuara nga neni 20 figuron edhe në pikën d) : e drejta e qytetarëve të Bashkimit European për t'i adresuar peticione Parlamentit European, si dhe e drejta për t'iu drejtuar Ombudsmanit European.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European gjithashtu në titullin V, të mbiquajtur "Qytetaria", në nenin 43 shprehet që: "çdo qytetar i Bashkimit European ose çdo person fizik ose juridik që ka rezidencën ose selinë e vet në një shtet anëtar të Bashkimit European ka të drejtë t'i drejtohet Ombudsmanit European në rast të keqadministrimit në veprimet e institucioneve, organeve ose organizmave të BE, me përjashtim të Gjykatës së Bashkimit European në ushtrimin e veprimtarive të saja juridiksionale." Kjo dispozitë është më e qartë sepse gjejmë informacione mbi kompetencën e mediatorit, personat që mund t'i drejtohen, objekti i ankesës, që është kryesisht rasti i keqadministrimit.

Një tjetër dispozitë në Traktatin e Lisbonës mbi Ombudsmanin European është edhe neni 228 i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, që përmban 4 paragrafë.

Gjejmë gjithashtu referenca përsa i përket Ombudsmanit european edhe në Kodin e Sjelljes dhe Etikës Administrative të institucioneve të BE-së. Ombudsmani ka kompetencë të veprorë në rastet e keqadministrimit nga institucionet, organet dhe organizmat e Bashkimit European. Në zbatim të nenit 228 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, Parlamenti European, duke vepruar nëpërmjet rregullores së tij të brendshme, në përputhje me një procedurë legjislative speciale, përcakton statusin dhe kushtet e ushtrimit të funksioneve të Ombudsmanit european. Ky status i bashkangjitet rregullores së brendshme të Parlamentit European.

Në fakt janë dispozitat e nenit 228 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, që na lejojnë të pohojmë se jemi në prezencë të një Ombudsmani european sepse: Ombudsmani european zgjidhet nga Parlamenti European. Në fakt, Ombudsmani European zgjidhet pas çdo zgjedhjeje të re që bëhet në Parlamentin European. Mandati i Ombudsmanit ka të njëjtën kohëzgjatje me atë të legjislaturës së Parlamentit European (një kohëzgjatje prej pesë vitesh). Ombudsmani pra, duhet të ketë besimin e Parlamentit European dhe të funksionojë në mënyrë të sinkronizuar me të. Ombudsmani european mban lidhje shumë të ngushta me Parlamentin European dhe për këtë arsye flitet edhe për Ombudsman parlamentar.

Por nga ana tjetër, nuk duhet supozuar që zgjedhja e Ombudsmanit nga Parlamenti European përbën një varësi të këtij të fundit nga Parlamenti European pikërisht sepse neni 228 i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European insiston mbi faktin që, Ombudsmani ushtron funksionet e tij në pavarësi të plotë. Në ushtrimin e detyrave të tij, siç e pohon edhe vazhdimi i tekstit të nenit përkatës, Ombudsmani nuk kërkon dhe nuk pranon udhëzime nga asnjë qeveri, institucion, organ ose organizëm.³ Paragrafi i 3 përcakton që, Ombudsmani gjatë mandatit të tij nuk mund të ushtrojë asnjë aktivitet profesional të paguar ose jo dhe kjo për të shmangur konfliktet e interesit dhe për të ruajtur pavarësinë e tij. Këto dispozita përbëjnë garanci në ruajtjen e pavarësisë së këtij organi të Bashkimit European.

Parlamenti European zgjedh Ombudsmanin, ndërhyr në kuadrin e procedurës së emërimit dhe luan një rol të rëndësishëm edhe në shkarkimin e tij. Në fakt neni 228 i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, paragrafi 2, pika 2 saktëson se nëqoftëse Ombudsmani nuk përmbush më kushtet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij, ose nëqoftëse ai bën një gabim të rëndë,

¹ <http://www.ombudsman.europa.eu/glance/fr/default.htm>

² Jean-Luc Sauron, « Cours d'Institutions européennes, Le puzzle européen », Gualino éditeur, 2000, fq.290

³ Charira Boutayeb, "Droit et institutions de l'Union européenne, La dynamique des pouvoirs", L.G.D.J, Lextenso Éditions, 2011, fq.126

Avokati i Popullit (Ombudsmani) European dhe Parlamenti European

(vijon nga faqja 4)

në këtë rast Gjykata Europiane e Bashkimit European mund ta deklarojë të shkarkuar. Kjo situatë është e ngjashme me atë të anëtarëve të Komisionit: vetëm gjykata mund t'i deklarojë të shkarkuar, por gjykata mund të veprojë në këtë rast vetëm me kërkesën e Parlamentit European.⁴

Lidhja e drejtpërdrejtë që mban Ombudsmani me Parlamentin European shihet edhe në leximin e nenit 228 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European, nga fakti se Ombudsmani është i detyruar në zbatim të këtij neni, paragrafi 1, pika 3 të paraqesë para Parlamentit European një raport vjetor të aktivitetit të tij, me anë të cilit ai jep llogari para Parlamentit European për veprimtarinë e tij gjatë vitit.

Përsëri në bazë të nenit 228 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European, Parlamenti European është drejtpërsëdrejti i lidhur me aktivitetet e Ombudsmanit. Në kuadrin e procedurave pranë Ombudsmanit, ankesat mund t'i transmetohen nëpërmjet ndërmjetësisë së një parlamentarit european. Gjithashtu, në rastin kur Ombudsmani ka hartuar një raport, ky i fundit i transmetohet direkt Parlamentit European.

Kontrolli i Ombudsmanit

Çështja që parashtrohet është për të ditur nëse ky kontroll i ushtruar nga Parlamenti së bashku me Gjykatën mbi një rast që kishte të bënte me statusin e Ombudsmanit, ishte ekskluziv mbi statusin juridiksional në lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij. Gjykata e drejtësisë është shprehur mbi këtë pikë, në një vendim të 23 marsit 2004 (Ombudsmani European/Franck Lamberts). Në këtë çështje pala paditëse kishte paraqitur një kërkesë për dëshmëpërbllim me arsyetimin e një trajtimi të gabuar të ankesës së paraqitur tek Ombudsmani.

Gjykata u shpreh se: "Megjithëse Ombudsmani disponon një hapësirë të gjerëvlerësimi në lidhje me pranueshmërinë e ankesave të paraqitura nga qytetarët, nuk i bie si detyrë në kontekstin e tij asnjë obligim rezultati dhe në këtë mënyrë kontrolli i gjykatës komunitar duhet të jetë i limituar." Por Gjykata shton gjithashtu se nuk përjashtohet mundësia që: "Në rrethana të jashtëzakonshme një qytetar të mund të vërtetojë që Ombudsmani ka kryer një shkelje të karakterizuar të së drejtës komunitare në ushtrimin e funksioneve të tij, sa që t'i shkaktojë një dëm qytetarit në fjalë." Gjykata shprehet se në këtë rast i duhet njohur e drejta e ankesës qytetarit, i cili do të mund të kompensohet për dëmet e shkaktuara. Gjykata shpjegon se kontrolli që Parlamenti ushtron mbi Ombudsmanin nuk përjashton kontrollin gjyqësor ndaj këtij të fundit. Raporti vjetor nuk i përafrohet një kontrolli gjyqësor. Por Bashkimi European është një Bashkim i së drejtës, që do të thotë se

institucionet e tij, organet dhe organizmat duhet të respektojnë rregullat e së drejtës. Gjykata përfundon se kontrolli gjyqësor mbi aktivitetin e Ombudsmanit nuk përbën një paralelizëm me kontrollin parlamentar. Në këtë vendim Gjykata njeht parimin e kontrollit gjyqësor mbi Ombudsmanin.

FUSHA E KOMPETENCAVE TË OMBUDSMANIT

Fusha e kompetencave racione personae

Në bazë të nenit 228 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European dhe të nenit 43 të Kartës së të Drejtave Themelore, ku gjejmë të njëjtën terminologji, bëhet fjalë për institucionet, organet dhe organizmat e Bashkimit European. Për të dhënë një përkufizim të institucioneve të Bashkimit European, i drejtohem nenit 13 të Traktatit mbi Bashkimin European, që numëron shtatë institucionet e Bashkimit European:

Parlamenti European, Komisioni European, Banka Qëndrore Europiane, Këshilli i Bashkimit European, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European, Gjykata e Auditorëve dhe Këshilli European.

Përsa i përket organeve të Bashkimit European, nuk ka ndonjë përcaktim në planin juridik dhe nga ana tjetër vetë Traktati i Lisbonës nuk jep ndonjë përkufizim. Konsiderohen si organe të Bashkimit European nga shumica e doktrinës, mekanizmat institucionale të parashikuara nga vetë Traktati. Bëhet fjalë për organe të Bashkimit European, përbërja dhe funksionimi i të cilave janë objekt i dispozitave të Traktatit: Komiteti i rajoneve është një organ konsultativ, që ndërhyt në procesin vendimmarrës; Komiteti ekonomik dhe social; Banka Europiane e Investimit; COREPER-i, që ndërhyt në përgatitjen e vendimeve të Këshillit.

Përsa i përket organizmave, ato zënë një vend më pak të rëndësishëm se organet e BE-së; bëhet fjalë për entitete, struktura që nuk janë të përcaktuara drejtpërsëdrejti nga dispozitat e Traktatit, por nga disa akte të marra në aplikim të Traktatit dhe që janë të krijuara nga institucionet dhe nganjëherë edhe nga organet e BE-së.

Disa fondacione

Paragrafi 1 i nenit 228 i Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European, fjalia e parafundit, na bën të konstatojmë, që përsa i përket Gjykatës së Drejtësisë, kompetenca e Ombudsmanit është e kufizuar meqë Ombudsmani nuk është kompetent në lidhje me dosjet që janë objekt i një procedure në Gjykatën e Drejtësisë. Vetë dispozita shprehet se "...me përjashtim të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European, në rastin e ushtrimit të funksioneve të veta gjyqësore." Megjithëse gjykatësi është i pavarur ndaj Ombudsmanit, kjo nuk do të thotë që ky i

⁴ Jean Boulouis, « *Droits Institutionnel de l'Union Européenne* », Montchrestien, 6^e édition, 1997, fq.77

(vijon në faqen 6)

Avokati i Popullit (Ombudsmani) European dhe Parlamenti European

(vijon nga faqja 5)

fundit nuk mund të pranojë një ankesë në lidhje me Gjykatën e Drejtësisë. Një funksionar për shembull mund të ankohet për keqadministrim të Gjykatës së Drejtësisë.⁵

Ombudsmani nuk është kompetent gjithashtu përsa i përket Agjencive Kombëtare dhe atyre rajonale ose lokale edhe në rastet kur në ankesat e këtyre agjensive bëhet fjalë për të drejtën europiane. Gjithashtu, Ombudsmani nuk është kompetent në lidhje me vendimet dhe aktivitetet e gjykatave kombëtare dhe ombudsmanëve kombëtare. Ekziston një rrjet ombudsmanesh, që do të thotë se Ombudsmani european punon në bashkepunim të drejtëpërdrejtë me ombudsmanet e tjerë, por që nuk ka kompetenca në lidhje me vendimet e tyre.⁶ Gjithashtu, Ombudsmani nuk interesohet në lidhje me ankesat kundër ndërmarrjeve ose personave fizikë.

Fusha e kompetencave racione materiae

Ombudsmani është kompetent për rastet e keqadministrimit. Neni 228 e parashikon qartazi keqadministrimin, por nuk jep një përcaktim në lidhje me të. Gjithashtu, neni 43 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European nuk na jep një përkufizim të keqadministrimit. Por gjithsesi kemi disa elemente të teksteve që na japin përgjigje:

Në Kodin e Sjelljes dhe Etikës Administrative; Në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European, e cila njeh të drejtën e një administrimi të mirë, të parashikuar në titullin V mbi qytetarinë. Neni 41 i Kartës, paragrafi 1 shprehet se: “çdo person ka të drejtë të shohë që çështjet e tij të trajtohen në mënyrë të paanshme e të drejtë dhe në një afat kohor të arsyeshëm nga institucionet, organet dhe organizmat e Bashkimit European.” Për më tepër, i njëjti paragraf parashtron një shpjegim plotësues: kuptojmë që e drejta e një administrimi të mirë shpërbëhet në një seri të drejtash specifike. Paragrafi 2 i nenit 41 parashikon dy të drejta dhe një detyrim që bien mbi administratën dhe shton edhe dy të drejta suplementare.

E drejta e çdo personi për t’u dëgjuar para se një vendim të jetë marrë. Personi në fjalë duhet të dëgjohet paraprakisht. Kjo e drejtë përfshihet në të drejtën e çdo personi për një proces të drejtë.

E drejta e çdo personi që të ketë akses në dosjen e tij. Kjo e drejtë duhet të zbatohet në bazë të respektit të parimit të konfidencialitetit dhe të sekretit profesional.

Detyrimet në ngarkim të administratës: detyrimi për të motivuar vendimet e veta, që do të thotë t’i tregohen

personit të interesuar arsyet e vendimit të marrë. Ky detyrim në të drejtën e BE-së është një detyrim i përgjithshëm, që përfshin të gjitha vendimet, të gjitha aktet.

Ky detyrim i institucioneve, organeve dhe organizmave të Bashkimit European për të motivuar vendimet e marra lidhet edhe me:

Të drejtën për t’u informuar: dhënia dhe shpjegimi i arsytimit të vendimit të marrë frenon çështjet gjyqësore;

Të drejtën për t’iu drejtuar gjykatësit në rast se arsytimi i dhënë duket i pamjaftueshëm;

Arsytimi i dhënë është pjesë e parimit të një procesi të drejtë sepse ka ndikim direkt mbi kontrollin juridik. Arsytimet e pamjaftueshme ose të përgjithshme janë të anuluar nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European në kuadrin e procedimit për anulimin e një vendimi.

E drejta e një administrimi të mirë përfshin gjithashtu edhe të drejtën e kompensimit nga BE-ja për dëmet e shkaktuara nga institucionet, organet dhe organizmat e saj, në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Në fund, e drejta e një administrimi të mirë, në nenin 41, paragrafi 4 parashikon të drejtën për çdo person për t’iu drejtuar BE-së në një nga gjuhët zyrtare të përzgjedhur nga vetë ai.⁷

Ombudsmani ka dhënë një përkufizim të keqadministrimit në vitin 1997, në një kohë kur nuk ekzistonte akoma Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European. “Ka keqadministrim kur një organizëm publik nuk vepron në përputhje me një parim, që për të ka forcë detyruese.”⁸

Rastet e keqadministrimit janë: Mungesa e transparencës; Vonesë në miratimin e një numri të caktuar aktesh; Refuzimi për të dhënë informacion; Diskriminimi; Padrejtësia; Mungesa e paanësisë; Abuzimi me pushtetin.

MËNYRAT E ANKESËS TEK OMBUDSMANI

Ankesa tek Ombudsmani –Tregues mbi prezantimin e një ankese

1. Autorët e një ankese

Leximi i nenit 228 na jep disa elemente të përgjigjes: bëhet fjalë për ankese nga ana e qytetarëve të BE-së ose të çdo personi fizik ose juridik (ndërmarrje, shoqata, etj) me rezidencë ose me seli në një shtet anëtar të BE. Nga pikëvështrimi i personave që kanë aftësinë të paraqesin një ankesë para Ombudsmanit, e drejta e BE-së përmban të

⁷ Jean-Luc Sauron, « Cours d’Institutions européennes, Le puzzle européen », Gualino éditeur, 2000, fq.298

⁸ Ky përkufizim është dhënë gjatë një mbledhjeje të ombudsmanëve europianë në shtator të 1997 dhe botuar më vonë edhe në raportin vjetor të Ombudsmanit European të vitit 1997 në Gazetën Zyrtare të Komunitetit European n°C 380 të 7 dhjetorit 1998, fq. 13.

⁵ Jean-Luc Sauron, « Cours d’Institutions européennes, Le puzzle européen », Gualino éditeur, 2000, fq.293

⁶ Claude Blumann, Louis Dubois, “Droit Institutionnel de l’Union Européenne”, Lexis Nexis Litec, 4^e édition, 2010, fq.311

(vijon në faqen 7)

Avokati i Popullit (Ombudsmani) European dhe Parlamenti European

(vijon nga faqja 6)

njëjtën zgjidhje, ashtu si për të drejtën e petitionit dhe shohim një përafrim të statusit të qytetarëve europiane me atë të personave që vijnë nga vende jo-anëtare të BE-së, por me rezidencë në një nga shtetet anëtare të BE-së.⁹ Duhet shtuar, gjithashtu, që ndërmjet personave juridikë, që mund t'i drejtohen Ombudsmanit janë edhe njësitë lokale dhe rajonale të shteteve anëtare të BE-së. Ombudsmani ka mundësinë që me vetë nismën e tij të fillojë një procedurë hetimi. Ai mund ta bëjë këtë gjë, në rastet kur vëren raste të dukshme të keqadministrimit, që përsëriten në mënyrë sistematike. Gjithashtu, Ombudsmani mund të hapë me nismën e tij një procedurë hetimore, kur një person që i drejton një ankesë Ombudsmanit nuk i plotëson kushtet e nenit 228: psh në rastin e një personi fizik, i cili ka shtetësinë dhe banon në një vend që nuk është anëtar i BE.

Ankesat mund t'i transmetohen, gjithashtu, Ombudsmanit edhe nga parlamentarët europianë, që luajnë një rol ndërmjetësi mes personave që mund t'i drejtohen Ombudsmanit dhe vetë Ombudsmanit.¹⁰

2. Cilat janë kushtet që duhet të përmbushë një ankesë për t'u pranuar nga Ombudsmani?

Neni 228 i Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European nuk parashikon asnjë kusht përpara i përket ankesave që parashtrihen tek Ombudsmani. Procedura e ankesave është një procedurë joformale, elastike, që ka si synim të garantojë qasjen më të madhe të mundshme të ankuesve ndaj Ombudsmanit. Në fakt, që një ankesë drejtuar Ombudsmanit të jetë e pranueshme, duhet që ajo të jetë e saktë, të figurojë në të emri i ankuesit dhe, gjithashtu, duhet që ankesa të jetë e nënshkruar.¹¹ Parlamenti european ka qenë i preokupuar që të hapë sa më shumë që të jetë e mundur procedurën e ankimit, ta bëjë sa më shumë të arritshme sepse kjo mundësi për t'u drejtuar Ombudsmanit duhet të jetë e hapur për ato që, për arsye kostojë dhe kohe, nuk dëshirojnë të angazhohen në një procedurë gjyqësore. Por, nga ana tjetër, një person nuk mund t'i drejtohet njëkohësisht edhe Ombudsmanit edhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European.

Duhet shtuar gjithashtu, që një ankesë duhet t'i drejtohet Ombudsmanit në një nga gjuhët zyrtare të BE-së. Ekziston edhe mundësia tjetër, që ankesa të hartohet në një gjuhë tjetër, me kushtin që kësaj të fundit t'i bashkangjitet një përkthim në një nga gjuhët zyrtare të BE-së. Ankesa te Ombudsmani duhet të paraqitet në një afat kohor prej 2 vitesh, duke nisur nga data në të cilën është marrë njohuri

për faktet mbi të cilat bazohet ankesa. Është përcaktuar ky afat prej 2 vitesh sepse me kalimin e këtij afati, keqadministrimi do të jetë i vështirë për tu identifikuar dhe për më tepër pas këtij afati administrata mund të ketë ndryshuar qëndrimin e saj dhe në këtë rast ndërhyrja e Ombudsmanit do të ishte e gabuar.¹²

Përpara se t'i drejtohem Ombudsmanit, fillimisht duhet t'i drejtohem institucionit, organit ose organizmit, i cili akuzohet për keqadministrim. Është në këtë nivel, që duhet kërkuar zgjidhja fillimisht. Ombudsmani ndërhyr vetëm në momentin kur dialogu mes të administruarit dhe administratës nuk ka gjetur zgjidhje. Ashtu sikurse edhe në të drejtën e petitionit, ankesa mund t'i drejtohet Ombudsmanit nëpërmjet rruges postare ose asaj elektronike. Kur një ankesë mbërrin tek Ombudsmani, ajo bëhet objekt i një regjistrimi, mban një numër dhe Ombudsmani mban në dijeni ankuesin në vazhdimësi në lidhje me ankesën e tij.

Trajtimi i ankesës nga Ombudsmani

Përsa i përket trajtimit të ankesës nga Ombudsmani, do të ekzaminohet edhe ajo që përbën pikën më të fortë të këtij organi të Bashkimit European, kompetenca për të zhvilluar hetime falë dëshmimeve, dokumenteve dhe informacioneve të ndryshme. Në fakt, Ombudsmani do të zhvillojë këto hetime dhe do të publikojë konkluzionet e hetimeve, të cilat do të bëhen të njohura edhe institucioneve, organeve dhe organizmave në fjalë. Ombudsmani nuk është thjesht vetëm një hetues, por ai kryen edhe rolin e një ndërmjetësi, që konsiston në përafrimin e pozicioneve të administratës dhe të të administruarit me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje. Kompetenca e tij për të kryer hetime të ndryshme dyfishon detyrën e tij si ndërmjetës dhe në kuadrin e kompetencave të tija të hetimit, Ombudsmani do të bashkëpunojë me Komisionin, i cili do ta furnizojë me një grup ekspertizë. Njëkohësisht, ai do të zhvillojë edhe një dialog me institucionin, organin ose organizmin, i cili akuzohet, për një rast keqadministrimi dhe siç ndodh shpesh në praktikë, keqadministrimi përfshin në të njëjtën kohë administratën e BE-së dhe administratën e shteteve anëtare të BE-së (për arsye të ndarjes së kompetencave dhe veçanërisht ajo që karakterizon funksionin ekzekutiv). Ombudsmani punon njëkohësisht edhe me instancat kombëtare dhe veçanërisht me ombudsmanët kombëtarë dhe rajonalë në shtetet e tjera (në rastin kur ekzistojnë të tillë). Që në 1996 është ngritur një rrjet european i ombudsmanëve i përbërë nga Ombudsmani european dhe ombudsmanët kombëtarë, që shkëmbejnë informacione mbi legjislacionet komunitare dhe mbi praktikatat më të mira dhe që nga viti 2008, bashkëpunimi ndërmjet ombudsmanëve është zgjeruar edhe në çështjet që përfshijnë të drejtat themelore.

⁹ Jean-Luc Sauron, « Cours d'Institutions européennes, Le puzzle européen », Gualino éditeur, 2000, fq. 292

¹⁰ Jean Boulouis, « Droits Institutionnel de l'Union Européenne », Montchrestien, 6^e édition, 1997, fq. 78

¹¹ Jean-Luc Sauron, « Cours d'Institutions européennes, Le puzzle européen », Gualino éditeur, 2000, fq.294

¹² IDEM.fq. 294

(vijon në faqen 8)

Avokati i Popullit (Ombudsmani) European dhe Parlamenti European

(vijon nga faqja 7)

Këto dispozita rezultojnë nga një vendim i Parlamentit European në 18 qershor 2008, i cili ka zgjeruar kompetencat e Ombudsmanit.¹³ Ky vendim i ka mundësuar Ombudsmanit një akses të plotë në dosjet e institucioneve, organeve, organizmave të BE-së, pra me fjalë të tjera, administrata e BE-së nuk mundet më t'i refuzojë Ombudsmanit dhënien e dosjeve duke evokuar sekretin.

Nëqoftëse pas përfundimit të hetimit Ombudsmani konstaton një rast keqadministrimi, ai i drejtohet institucionit, organit ose organizmit, që disponon një afat kohor prej 3 muajsh për të kthyer përgjigje, së bashku me një motivim.

Në mënyrë të përmbledhur, procedura hetimore zhvillohet në këto etapa:

Faza kur personi i interesuar duhet të ketë kontakt me administratën;

Ombudsmani kur i drejtohet personi në fjalë, kontakton me administratën për të gjetur një zgjidhje me pëlqimin e të dyja palëve;

Nëqoftëse një zgjidhje me pëlqimin e të dyja palëve nuk është e mundur, do të zhvillohet një hetim. Shumë shpesh në këtë stad arrihet rezultat meqenëse mjaft shpesh administrata e pranon që ka një problem dhe angazhohet ta korrigjojë.

Nëqoftëse administrata në fjalë këmbëngul, Ombudsmani i transmeton një raport Parlamentit European dhe institucionit, organit ose organizmit në fjalë. Është nëpërmjet rrugës së reklamimit të një rasti keqadministrimi, që Ombudsmani synon të bëjë presion mbi administratën, që kjo e fundit të respektojë ligshmërinë. Personi, që ka bërë ankesën mbahet vazhdimisht në dijeni mbi rezultatit e hetimeve.¹⁴

Ky është një mekanizëm, që nuk ka të bëjë fare me një procedurë gjyqësore. Nëqoftëse ndodhemi në raste keqadministrimi të vazhdueshëm, rekursi gjyqësor është i mundur.

PRAKTIKA

A. Aktiviteti i Ombudsmanit European

Nëqoftëse marrim parasysh raportin e vitit 2010 të Ombudsmanit European në lidhje me ankesat, që i janë drejtuar, do të vërejmë se ka një ulje të numrit të ankesave në 2010, por nga ana tjetër, përqindja e ankesave që nuk janë pjesë e kompetencave të këtij organi të BE-së janë shtuar në mënyrë relative.

Gjatë vitit 2010, Ombudsmani european ka hapur mbi

335 hetime dhe, po këtë vit ka mbyllur 326 hetime. Nëqoftëse i hedhim një sy aspektit sasior, Ombudsmani ka mundur të japë një zgjidhje të kënaqshme për palët, sepse ose ka dhënë një zgjidhje direkte për to, ose sepse ai ju ka dhënë informacionin e nevojshëm se kujt t'i drejtohen.

Përsa i përket riorientimit të ankesave, 50% e ankesave janë riorientuar drejt ombudsmanëve kombëtarë, në shtetet anëtare të BE-së.

Nëqoftëse interesohemi përsa i përket ankesave, pjesa më e madhe e ankesave vijnë nga qytetarët, persona fizikë, të cilët përbëjnë 78% të ankesave, ndërsa ndërmarrjet dhe shoqatat e kanë më të vështirë për t'iu drejtuar Ombudsmanit european.

Nëqoftëse marrim parasysh, përfundimin e hetimeve, është konstatuar që në 2010, 179 çështje janë mbyllur, qoftë sepse institucioni në fjalë ka pranuar një zgjidhje me pëlqimin e përbashkët të palëve, qoftë sepse ai ka rregulluar konfliktin, kur nuk ka pasur raste të keqadministrimit.

Disa raste keqadministrimi janë sinjalizuar në 40 çështje të ndryshme dhe në këto 40 çështje, 7 kanë qenë objekt i projekteve të rekomandimit nga institucionet dhe në 3 raste të tjera Ombudsmani, përballë kundërshtimit të administratës, është detyruar të bëjë disa komente kritike dhe në një rast ka pasur edhe një raport special, adresuar Parlamentit European.

Është konstatuar, që në 14 çështje Ombudsmani ka hartuar disa vërejtje shtesë. Ombudsmani arrin pra në shumë raste, të bëjë të mundur, që administrata të gjejë një zgjidhje të drejtë ose t'i japi fund një rasti me keqadministrim.

Konstatohet gjithashtu (është një konstatim, që i bëhet Ombudsmanit, që prej krijimit të tij), që institucioni, që përbën objektin e aktivitetit më të shumtë të Ombudsmanit european është Komisioni European, për arsye të vetë karakteristikave të këtij institucioni, sepse merr vendime të ndryshme, që kanë një impakt direkt në jetën e përditshme të qytetarëve europianë.

Në vitin 2010, 200 çështje janë drejtuar kundër:

Komisionit European – 55% të ankesave në total

Epo (Zyra Europiane e seleksionimit të personelit) – 10 % të ankesave

Parlamenti European - 17 %

Këshilli i BE - 20 %

Gjykata e Drejtësisë e BE - 1%

B. Cilat janë rastet më të shumta të keqadministrimit, të paraqitura përpara Ombudsmanit?

Nëqoftëse i drejtohem raportit të 2010, duhet thënë që Ombudsmanit i drejtohen më së shumti qytetarët europianë, për arsye si psh: administrata nuk i shërben ankuesit, udhëzimet ose informacionet e kërkuara prej tij:

30,4 % e ankesave, përbëjnë raste në lidhje me keqadministrimin, në formën e refuzimit të kërkesave në lidhje me informacione të ndryshme.

(vijon në faqen 9)

¹³ <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&reference=P6-TA-2008-0301&language=FR>

¹⁴ Claude Blumann, Louis Dubois, "Droit Institutionnel de l'Union Européenne", Lexis Nexis Litec, 4^e édition, 2010, fq.311

Avokati i Popullit (Ombudsmani) European dhe Parlamenti European

(vijon nga faqja 8)

Rasti i dytë i keqadminstrimit, ka lidhje me shkeljen e ligjshmërisë. Mund të bëhet fjalë qoftë për rregulla substanciale, shkelje e të drejtave themelore, por gjithashtu mund të bëhet fjalë për shkelje të rregullave të procedurave, veçanërisht, fakti që administrata refuzon të dëgjojë palën e interesuar në rastin kur ajo ka mundësinë të japë sanksione ndaj kësaj pale.

Përmes rasteve të shkeljes së ligjshmërisë figurojnë rastet e aplikimit të rregullave substanciale ose proceduriale.

14,1 % e ankesave kanë lidhje me mosnjohjen e afateve të arsyeshme për administratën.

Në 11% të rasteve bëhet fjalë për shkeljen e paanshmërisë dhe gjithashtu për kërkesat për akses të dokumentave, që nuk ia arrijnë qëllimit si dhe për rastet ku administrata nuk arsyeton ose arsyeton në mënyrë të pamjaftueshme vendimet e saj. Për më tepër duhet përmendur edhe rasti kur administrata nuk i përgjigjet ankuesve në gjuhën, që ata kanë përdorur për t'iu drejtuar asaj, pastaj ka vërejtje edhe për çështjen e diskriminimit.

C.Kush drejton ankesa më së tepërmi tek Ombudsmani?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje duhet marrë parasysh llogaritja e popullatës së një shteti, dhe në raportin e 2010, konstatohet se numri më i madh, që i drejtohen Ombudsmanit, janë nga Luksemburgu. Nga përqindja e ankesave në total, 12,7 % vijnë nga ky vend sepse ndodhet pranë selive të institucioneve, organeve dhe organizmave

të tjera të BE-së. Pastaj vjen Qiproja me 4,1 % dhe Belgjika me 3,7 % të ankesave, të ndjekura nga Malta dhe Sllovenia.

Përsa i përket Francës, nuk rezulton si vend që preferon t'i drejtohet Ombudsmanit european me 0,7 % të ankesave në total të drejtuara drejt tij.

Bibliografia

Version i Konsoliduar i Traktatit mbi Bashkimin European dhe Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European;

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European;

Charira Boutayeb, "Droit et institutions de l'Union européenne, La dynamique des pouvoirs", L.G.D.J, Lextenso Éditions, 2011 ;

Jean-Luc Sauron, « Cours d'Institutions européennes, Le puzzle européen », Gualino éditeur, 2000 ;

Jean Boulouis, « Droits Institutionnel de l'Union Européenne », Montchrestien, 6^e édition, 1997 ;

Claude Blumann, Louis Dubois, "Droit Institutionnel de l'Union Européenne", Lexis Nexis Litec, 4^e édition, 2010 ;

Adresa zyrtare e Ombudsmanit European në web: <http://www.ombudsman.europa.eu/fr/home.faces>;

Raporti Vjetor i Ombudsmanit European 2010: <http://www.ombudsman.europa.eu/activities/annualreports.faces>;

Adresa zyrtare e Parlamentit European në ëeb : <http://www.europarl.europa.eu/portal/fr>;

Gazeta Zyrtare e Komunitetit European n°C 380, 7 dhjetor 1998.

Taulant Troshani

Neni 68 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe përafrimi i legjislacionit European

Neni 68 dhe struktura e tij

Neni 68 i Rregullores¹ së Kuvendit të Shqipërisë (Rreg) shprehet sa më poshtë vijon:

1. E drejta për të propozuar ligje i takon Këshillit të Ministrave, çdo deputeti dhe 20 mijë zgjedhësve.

2. Projektligjet duhet të jenë të hartuara në formën e një akti normativ dhe të jenë të shoqëruara me një relacion, i cili duhet të përmbajë objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij, argumentet se këta objektiva nuk mund të arrihen me instrumentet ligjore ekzistuese, përputhshmërinë

¹ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e miratuar me Vendim nr. 166, datë 16.12.2004 dhe e modifikuar me Vendim nr. 193, datë 07.07.2008, Vendim nr. 15, datë 27.12.2005, Vendim nr. 21, datë 04.03.2010, Vendim nr. 41, datë 24.06.2010, Vendim nr. 88 datë 24.02.2011, Vendim nr. 89 datë 24.02.2011.

e projektligjit me Kushtetutën, harmonizimin me legjislacionin në fuqi dhe legjislacionin e Bashkimit European, si dhe efektet e tij sociale dhe ekonomike. Për projektligjet me karakter financiar, relacioni duhet të përmbajë edhe efektet e pritshme financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij.

3. Asnjë projektligj joqeveritar, që rrit shpenzimet e Buxhetit të Shtetit ose pakëson të ardhurat e tij, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit. Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda këtij afati, projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme.

4. Kryetari i Kuvendit, në mënyrë të arsyetuar, mund të kthejë te nismëtari projektligjet e depozituara, në rast se nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 68 i Rregullores së Kuvendit përcakton qartë disa kritere të cilat duhet të respektohen në mënyrë që një

(vijon në faqen 10)

Neni 68 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe përafrimi i legjislacionit European

(vijon nga faqja 9)

projektligj të futet në procedurat parlamentare sipas pikës 4 të këtij neni. Një projektligj vijon rrugëtimin e tij të shqyrtimit në strukturat administrative dhe politike të pushtetit legjislativ. Në momentin kur projektligji i dërgohet parlamentit, akti normativ fillon fazën e shqyrtimit apo quajtur ndryshe edhe leximi i projektligjit. Në këtë drejtim dhe në aspektin juridik, ka dy mendime për leximin e një projektligji. Metoda e parë² konsiderohet si respektimi i procedurave parlamentare për pranimin nga Kuvendi i një akti normativ në përputhje të pikës 1 të nenit 68 të Rreg. Një projektligj duhet të jetë propozuar nga Këshilli i Ministrave, nga 20 000 zgjedhës ose çdo deputet me kriteret që vijnë në pikat e tjera. Pastaj trajtimi i një projektligji nga strukturat e brendshme politike të Kuvendit siç janë komisionet parlamentare siç quhen edhe shpesh “motorri i legjislativit”, (leximi i dytë) si dhe leximi i tretë në seancë plenare nga ku del edhe varianti përfundimtar i projektligjit, i cili dërgohet pastaj për dekretim nga Presidenti i Republikës dhe publikimi i tij sipas dispozitave të parashikuara në atë ligj. Metoda e dytë³, e cila në një farë mënyre do të jetë edhe objekt diskutimi në këtë material, është kur projektligji miratohet në parim, nen për nen dhe në tërësi, si në komisione⁴, ashtu edhe në seancë plenare.

Këta dy metoda leximi të cilat janë edhe të shprehura në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 68 pika 2 dhe 4, dhe nga ku përcaktohen kriteret e leximit të parë. Në këtë lexim, nëqoftëse nuk përmbushen kriteret e pikës 2 të nenit 68, atëherë Kryetari i Kuvendit, sipas pikës 4 të këtij neni ka të drejtë ta kthejë pas me një mendim të arsyetuar. Kurse leximi i dytë bazohet në nenin 38 pikat 3, 5 dhe 6. Ndërsa leximi i tretë bëhet kur projektligji kalohet në seancë plenare për miratimin e tij përfundimtar bazuar në nenet 74, 75 dhe 77 të Rregullores.

Projektligji duhet të ketë një relacion shpjegues në të cilën pasqyrohen respektimi i Kushtetutës, harmonizimi me ligjet në fuqi, përputhshmëria me legjislacionin e Bashkimit European, efektet sociale dhe ekonomike. Në metodën e

parë të leximit (pranimi në procedurat parlamentare, në rast të kundërt, bazuar në pikën 4 të nenit 68 të Rregullores, projektligji mund/duhet të kthehet tek nismëtari) që i bëhet në Kuvend një projektligji, një ndër kriteret që një projektligj duhet të përmbushë është edhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*. Duke u bazuar në nenin 70 të MSA⁵, përafrimi i legjislacionit është një ndër detyrimet që Shqipëria ka marrë në kuadër të procesit të integritimit europian.

Megjithatë, çështja e përafrimit është një nga problemet e debatuar në shumë hapësira institucionale dhe ka një rrugëtim që duhet ndjekur sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave⁶. Çdo projektligj që është në përmbushje të detyrimeve të MSA dhe përafrohet me legjislacionin europian duhet të shoqërohet me tabelën e përputhshmërisë. Pas miratimit në KM të vendimit për një projektligj, ky i fundit i kalon Kuvendit dhe futet në procedurat parlamentare për shqyrtim. Siç u tha edhe më lart një ndër çështjet kryesore që duhet të konsiderohet është edhe përafrimi i legjislacionit.

Koncepti i përafrimit dhe detyrimet e Shqipërisë

The approximation of law is a unique obligation of membership in the European Union. It means that countries aspiring to join the European Union must align their national laws, rules and procedures in order to give effect to the entire body of EU law contained in the *Acquis Communautaire*⁷.

Përsa i përket këtij koncepti, siç u tha edhe më lart, ai bazohet në nenin 70 të MSA, i cili shprehet se Shqipëria ka një detyrim për të përafuar legjislacionin komunitar, apo siç edhe quhet tashmë pas ratifikimit të Traktatit të Lisbonës, *Aquis* e Bashkimit European në mënyrë progresive, për një periudhë 10 vjecare (neni 6 i MSA).

Në përafrimin e legjislacionit, duhet të ndahen dy momente, ose dy kategori vendesh: së pari, janë vendet anëtare të cilët tashmë kanë përafuar të gjithë legjislacionin e tyre me atë të Bashkimit European, por duke konsideruar që legjislacioni komunitar ka karakter dinamik duke iu përgjigjur të gjitha nevojave të kohës, ai përditësohet

² <http://www.parliament.uk/documents/commons-information-office/101.pdf>, fq 4-6.

³ Manzella, A., *Il Parlamento, Il Mulino, Bologna, Terza edizione, 2003*, fq 309.

⁴ Ka gjithashtu një diskutim se Komisioni për dhënie mendimi apo komisioni përgjegjës nuk e përfundojnë projektligjin në kuptimin se gjatë shqyrtimit në komisione, projektligji miratohet në parim dhe nen për nen me të gjitha ndryshimet e propozuara dhe të votuara. Por në mendimin tim personal, pavarësisht se ajo nuk jepet shprehimisht, komisioni miraton edhe në tërësi projektligjin duke marrë parasysh që procedura konsiderohet e përfunduar në komisione para se të dërgohet në seancë plenare. Mendimet janë të ndryshme dhe në të njëjtën kohë të vlefshme.

⁵ Ligji nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe Shteteve anëtare”.

⁶ Vendim nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, i amenduar me VKM nr 201 datë 29.03.2006 dhe me VKM nr. 4 datë 07.01.2009.

⁷ Guide to the approximation of the European Union Environmental legislation in <http://ec.europa.eu/environment/archives/guide/guidfin.pdf> fq. 8.

(vijon në faqen 11)

Neni 68 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe përafrimi i legjislacionit European

(vijon nga faqja 10)

vazhdimisht dhe në këtë mënyrë shtetet anëtare nuk janë të përjashtuara nga ky proces. Madje duhet të thuhet se në përafrimin e legjislacionit komunitar nga shtetet anëtare, detyrimet janë edhe më të mëdha, duke konsideruar se rregulloret janë të detyrueshme në terësinë e tyre për t'u përafruar dhe për t'u futur në legjislacionin vendas ashtu siç janë.

Kategoria e dytë e vendeve janë ato vende të cilat janë kandidat apo kandidatë të mundshëm për anëtarësimin. Përafrimi i legjislacionit, në këto raste duhet të bëhet në mënyrë graduale. Pikërisht përsa i përket Shqipërisë, neni 6 i MSA, thotë që ky proces duhet të përvijojë në një periudhë 10 vjeçare maksimumi, me dy afate të ndërmjetme prej 5 vjetësh, duke filluar që nga ratifikimi i MSA⁸. Në rastin e Shqipërisë, MSA është firmosur në vitin 2006 dhe ka hyrë në fuqi me 1 prill 2009 me ratifikimin e të gjitha vendeve anëtare, faza e përafrimit përfundon me 1 prill 2013.

Procesi, natyrisht kërkon disa hapa paraprake për përafrimin e legjislacionit dhe gjatë procesit të përafrimit duhet të mbahen parasysh disa kriteret: legjislacioni vendas a e mbulon një fushë specifike dhe sa e mbulon atë; cilat janë standartet që janë përfshirë në këtë legjislacion. Pasi të jenë identifikuar ligjet dhe normat në fuqi, ato duhet të krahasohen me legjislacionin komunitar nen për nen. Krahasimet e legjislacionit vendas me atë komunitar, përfshihen në të ashtuquajturën tabela e përputhshmërisë dhe në të, kur një ligj bazë apo i ndryshuar, dërgohet për ndryshim në Kuvend (në formën e projektligjit të ri), duhet të shoqërohet me të ashtuquajturën tabelën e përputhshmërisë, në të cilën pasqyrohen, ligji që ndryshohet, *acquis* e BE që përafrohet, nenet përkatëse të të dy normave, sa janë përafruar, (pjesërisht apo plotësisht) si dhe arsyet përse përafrimi nuk është i plotë në rast se ai nuk është i tillë.

Për hartimin e projektligjeve, duke u nisur nga nevojat konkrete të vendit, nga teknika legjislative dhe kushtetutshmëria e ligjit si dhe kostot përkatëse të një ligji, janë dikasteret përkatëse të cilat japin mendimin e tyre. Respektivisht, janë Ministria propozuese, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave. Në rastin e përafrimit, Ministria e Integritimit European është e detyruar të japë

⁸ Në këtë periudhë 10-vjeçare, lëvizja e lirë e mallrave bën përjashtim. Titulli IV i MSA e cila ka hyrë në fuqi me marrëveshjen e përkoshme ndërmjet shteteve anëtare e Bashkimit European dhe Shqipërisë: Ligji nr 9591, datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së ndërmjetme për lëvizjen e lirë të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe Shteteve anëtare".

mendimin e saj mbi përafrimin para se akti normativ të dërgohet në KM për vendim. Në të gjitha ministritë e linjës, janë ngritur struktura për Integrimin European, të cilat kanë në kompetencat e tyre jo vetëm monitorimin e procesit dhe zbatimin e standarteve apo koordinimin e procesit brenda dikasterit dhe në raport me strukturat përkatëse, por në të njëjtën kohë duhet të kontrollojnë legjislacionin european i cili bëhet detyrim për Shqipërinë në bazë të MSA-së.

Shkurtimisht, sa u përmend më sipër, *iter*-i i formimit të një ligji është i gjatë dhe i ndërlikuar. Megjithatë e gjithë procedura është e nevojshme.

Përsa i përket përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, në fazën e dytë, duhet të plotësohen të gjitha kërkesat e paraqitura nga Bashkimi European. Ky është një ndër kriteret, por ka edhe të tjerë.

Neni 68 dhe përafrimi i legjislacionit

Projektligjet që paraqiten në Kuvend mund t'i ndajmë në dy lloje: projektligje bazë dhe ato që ndryshojnë një ligj ekzistues.

Në rastin e parë, procedura e përafrimit të legjislacionit nuk paraqet ndonjë kërkesë të veçantë duke konsideruar se një fushë që pretendon të mbulojë një sektor të veçantë nuk është konsideruar ndonjëherë ose natyra e situatës ka ndryshuar në atë masë sa që ligji ekzistues nuk është më i mjaftueshëm për t'iu përgjigjur nevojave të kohës. Një rast që mund të përmendet në këtë punim mund të jetë projektligji për mbrojtjen e mjedisit⁹. Në nenin 73 parashikohet shfuqizimi i Ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e Mjedisit", të ndryshuar. Projektligji i ri tashmë është futur në procedurat parlamentare dhe pritet të shqyrtohet së shpejti në komisionet e përhershme dhe të kalojë në seancë plenare për miratimin e tij.

Ky projektligj përafrohet me direktivat 2004/35/EC "Mbi përgjegjësinë mjedisore", të amenduar nga Direktiva 2006/21/EC dhe nga direktiva 2009/31/EC.

Në projektligjin e ri përfshihen një sërë kriteresh dhe standardesh europiane për mbrojtjen e mjedisit të cilat nuk ishin të përfshira në ligjin në fuqi. Ligji ekzistues është amenduar disa herë, por propozimi i projektligjit të ri, në rast se do të ndryshonte ligjin ekzistues, do të ndërhynte në 60 përqind të pjesës substanciale të tij sipas relacionit shpjegues të Vendimit. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, gjithmonë në relacionin shpjegues "*del i nevojshëm konsolidimi i një akt(i) të vetëm*".

Në këtë kuptim përafrimi është në respektim të nenit 70 të MSA-së dhe të neneve që kanë të bëjnë me mjedisin¹⁰, si dhe me nenin 60 të Rregullores.

⁹ Vendim nr. 181, datë 02.02.2011 Për propozimin e projektligjin "Për mbrojtjen e Mjedisit."

¹⁰ Neni 108 i MSA.

(vijon në faqen 12)

Neni 68 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe përafrimi i legjislacionit European

(vijon nga faqja 11)

Formulimi i një akti të ri kur kuadri ligjor ekzistues nuk është i mjaftueshëm për rregullimin e një fushe specifike është i nevojshëm dhe, në një fare mënyre, i detyrueshëm për t'iu përgjigjur nevojave të kohës me një legjislacion i cili do t'i përgjigjet kërkesave të shoqërisë.

Por ka raste kur një fushë është krejtësisht e re dhe ka nevojë për hartimin e një kuadri ligjor për të përmbushur një *vacuum* ligjor. Natyrisht në këtë kuptim, një studim fizibiliteti dhe një përshtatje në përputhje me kushtet e vendit dhe detyrimeve të angazhimeve europiane do të nxisin propozuesit e një projektligji për hartimin sa më të shpejtë të një të tilli.

Por do të duhej të konsiderohej një rast më specific. Nëqoftëse një ligj është i përputhur pjesërisht me *acquis* dhe pas një farë kohe shfaqet e nevojshme që ky ligj të amendohet përsëri, a duhet ky ligj të marrë parasysh pikën 2 të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit për sa i përket tabelës së përputhshmërisë?

Për trajtimin e këtij argumenti do të lëvizim kryesisht në dy drejtime. Drejtimi i parë është krahasimi me një projektligj tjetër për sa i përket respektimit të nenit 68, pika 2 dhe në drejtimin që jep për sa i përket nenit 6 të MSA-së.

Në nenin 68 thuhet se “*Projektligjet (të gjitha¹¹) duhet të jenë të hartuara në formën e një akti normativ dhe të jenë të shoqëruara me një relacion, i cili duhet të përmbajë objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij, argumentet se këta objektiva nuk mund të arrihen me instrumentet ligjore ekzistuese, përputhshmërinë e projektligjit me Kushtetutën, harmonizimin me legjislacionin në fuqi dhe legjislacionin e Bashkimit European, si dhe efektet e tij sociale dhe ekonomike. Për projektligjet me karakter financiar, relacioni duhet të përmbajë edhe efektet e pritshme financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij*”.

Kur thuhet se “*projektligjet duhet*”, kuptohet qartë se nuk ka projektligje që bëjnë përjashtime. Të gjitha projektligjet, duhet të ketë formën e një akti normativ, të kenë relacionin dhe elementet e tjerë sikurse janë edhe të përshkruara qartë në pikën 2 të nenit 68. Ky nen, në një lexim të gjithanshëm, shprehet se *të gjitha* projektligjet duhet të kenë një tabelë përputhshmërie.

Siç është edhe shkruar më lart, në përmbushje të detyrimeve të MSA disa projektligje janë të shoqëruar me tabelën e përputhshmërisë për ato nene që janë të përafuar me direktivat dhe me rregulloret e Bashkimit European. Ka edhe projektligje të cilët nuk kanë një përputhshmëri me *acquis*, por në rastin konkret, sikurse relacionet e ligjeve përkatëse japin shpjegime se a ka apo jo kundërshtime me Kushtetutën apo me ndonjë ligj tjetër, ka apo jo kosto financiare, në këtë linjë interpretimi të nenit 68 pika 2, relacioni shpjegues duhet të përmbajë edhe një referim ka apo nuk ka përafrim legjislacioni në fushën që ligji po trajton.

¹¹ Koment i autorit.

Rasti tjetër është kur një projektligj është paraqitur me tabelë përputhshmërie dhe është amenduar më vonë. Sipas nenit 68 pika 2 për sa u tha në paragrafin e mëparshëm duhet të ketë një tabelë përputhshmërie për faktin se duhet të respektojë pikërisht këtë dispozitë por edhe për të shpjeguar se nenet e amenduara nuk janë prekur në përputhshmërinë e tyre me *acquis* si dhe nenet të tjera që mund të përfshihen, duhet të kenë shpjegimin se për ato nuk ka detyrim përputhshmërie me *acquis*. Në rast të kundërt, legjislatori, me të drejtë mund të kërkojë një verifikim si në momentin e leximit të parë në respektim të procedurave, sikurse është parashikuar në pikën 4 të nenit 68 të Rregullores po ashtu edhe gjatë shqyrtimit të tij në organet e institucionit ligjvënës, Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë rast, kompetent është Komisioni Parlamentar për Integrimin European i cili pas miratimit të projektligjit, përgatit një raport mbi konsiderimet e ndryshme si dhe ndryshimet e nevojshme.

Rasti i tretë kur një projektligj i përafuar dhe i ndryshuar duhet të ketë një referencë në përafrimin e legjislacionit është në respektim të neneve 70 dhe 6 të MSA i cili shprehet se përafrimi i legjislacionit duhet të bëhet në një periudhë 10 vjeçare me dy nënperiudha nga 5 vjet secila sipas nenit 6, paragrafi i fundit. Në këtë rast, sidomos në fazën e dytë ku duhet të arrijë *asociimin e plotë*, në këtë periudhë që tashmë po futemi bazuar MSA që nga momenti i hyrjes në fuqi së saj¹² ligjet duhet të jenë të përafuara plotësisht me *acquis* në fushat përkatëse.

Në këtë rast, së pari, duhet treguar pjesa që është përafuar më parë dhe plotësimi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë europian. Në relacionin shpjegues mund të argumentohen arsyet e rishikimit të ligjit. Së dyti, ligjet që janë përafuar tërësisht në nene të veçanta apo në tërësinë e tyre duhet të shpjegojnë arsyet përse një ligj nuk mund të ketë tabelë përafrimi dhe, së treti, nëqoftëse një projektligj nuk përafrohet me legjislacionin europian, duhet të shpjegohen arsyet se pse nuk ka një përafrim dhe shpjegohen arsyet për mungesën e kostove financiare dhe kritere të tjera për sa i përket respektimit të nenit 68.

¹² Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit, pas ratifikimit të 25 shteteve anëtare ka hyrë në fuqi më 1 prill 2009. Në <http://mie.gov.al/> në respektim të nenit 6 paragrafi i fundit, periudha e parë 5 vjeçare mbaron në prill të vitit 2014. Në sintoni me këto afate ligjore janë përgatitur edhe dokumentat programatik të Qeverisë, si Strategjia për Integrimin European si dhe Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr 862, date 22.07.2009.

(vijon në faqen 13)

Neni 68 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe përafrimi i legjislacionit European

(vijon nga faqja 12)

Komisioni i Integritimit European dhe neni 68

Komisioni i Integritimit, bazuar në nenet 19 dhe 68 të Rregullores, ka si fushë të kompetencave të tij integrimin european, pra, shqyrtimin e projektligjeve që lidhen me procesin e integritimit, mbikqyrjen e qeverisë dhe institucioneve të krijuara me ligj që raportojnë në Kuvend për ecurinë e tyre në fushat e integritimit european si dhe funksionin zgjedhor përsa i përket po këtij procesi.

Duke u bazuar në nenin 68, Komisioni i Integritimit deri në këto momente ka shqyrtuar të gjitha projektligjet të cilët kanë patur një tabelë përputhshmërie, duke shqyrtuar si frymën europiane të këtyre ligjeve, respektimin e normave në fuqi, ato parësore, dytësore si dhe të ashtuquajturin *soft law*. Por deri më sot nuk është ngritur çështja se a duhet të shqyrtohen nga Komisioni i Integritimit projektligjet që nuk kanë tabelë përputhshmërie si dhe ato ligje të përafuara të cilët më vonë kanë pësuar amendime.

Duke marrë parasysh që shumë ligje duhet të rishikohen në fazën e dytë, në periudhën e plotësimit të standarteve ose të përafrimit të plotë, Komisioni në fjalë duhet të konsiderojë një interpretim më të gjerë të nenit 68. Sikurse u përmend edhe në rastet më lart, Komisioni duhet të shqyrtojë projektligjet bazë të përafuar, ato që bëjnë ndryshime në ligje që janë të përafuar, plotësisht apo pjesërisht dhe ato ligje që është parashikuar të përafrohen në fazën e dytë.

Komisioni i Integritimit, në këtë perspektivë do të ushtrojë detyrën e tij në procesin ligjvënës dhe do të rrisë ndërgjegjësimin, ekspertizën dhe mendimin që duhet të japë në lidhje me miratimin e ligjeve dhe të ndryshimeve të nevojshme.

Në këtë mënyrë, neni 68 do të respektohet në tërësinë e tij si formalisht, përsa i përket procedurave, po ashtu

edhe në përmbajtje të akteve normative (projektligjeve).

Ndërgjegjësimi për interpretim të gjerë të nenit 68 dhe krijimin e një baze të të dhënave do të rrisë funksionin kontrollues të Kuvendit të Shqipërisë, në veçanti Komisionit të Integritimit ku edhe monitorimi i planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit do të jetë më i frytshëm.

Kjo është një nga mënyrat për rritjen e kontrollit parlamentar për integrimin european, për të përmirësuar ndarjen e pushteteve sipas nenit 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mirëfunksionimin e demokracisë në Shqipëri, që sipas rekomandimeve të Komisionit European, ka nevojë për progres të vazhdueshëm. Demokracia është një ide, kurse demokratizimi është një proces në të cilin edhe vendet anëtare të Bashkimit European nuk janë të përjashtuara.

Për këto arsye, si Qeveria ashtu edhe Kuvendi, pranë sekretariatit tij ose pranë njësisë së përafrimit të legjislacionit mund të krijojë një bazë të dhënash nga ku mund të kontrollohet lehtësisht rruga e përafrimit të një ligji. Kjo do të shmangte mbivendosje dhe ndërhyrje jo të përshtatshme në ligje të cilët janë përafuar edhe më parë. Për një punë edhe më të mirë dhe për t'i paraprirë një punë të detyrueshme për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European, i cili është i detyrueshëm, e gjithë normativa duhet të përkthehet dhe duhet të shoqërojë një projektligj në formë zyrtare. Këto rekorde do të ndihmojnë, si përkthimin e legjislacionit në kohë, dhe shqyrtimin e projektligjeve, ku gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe dhe çdo qytetar duhet të informohet në gjuhën që njeh, si dhe do t'i lejojë çdo qytetari të njihet me detyrimet dhe të drejtat që lindin nga ligjet në fuqi.

*Denis Gila**

* Denis Gila është funksionar i Kuvendit të Shqipërisë. Mendimi i shprehur këtu nuk përbën mendim zyrtar të institucionit.

Raport për veprimtarinë e Komisionit të Integritimit European Shtator – Nëntor 2011

Historiku i shkurtër i Komisionit¹

Komisioni për Integrimin European ka një histori të shkurtër. Fillimi i kësaj strukture mund të konsiderohet vendimi i Kuvendit nr 37, datë 16.05.2002, "Për krijimin e Komisionit të Integritimit European dhe Paktit të Stabilitetit". Bazuar në nenin 77 pika 1 të Kushtetutës në të cilin thuhet se "Kuvendi zgjedh nga gjiri i saj komisione të përhershme si dhe mund të përcaktojë komisione të posaçme". Me

vendimin e mësipërm u ngrit Komisioni *ad hoc* për Integrimin European dhe për Paktin e Stabilitetit. Gjithashtu, për ngritjen e këtij komisioni Kuvendi është bazuar edhe në Rregulloren e tij si pasojë e detyrimeve që lindin nga zbatimi i procesit të integritimit european dhe Paktit të Stabilitetit dhe në veçanti hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (neni 1 i vendimit).

Duke u bazuar në nenin 2 të po këtij vendimi, Komisioni është ngritur me propozim të Komisionit të Jashtëm dhe sipas po këtij komisioni, në strukturën e re do të përfshiheshin përfaqësues të komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit.

¹ Informacioni është marrë pranë Komisionit të Integritimit European dhe është bazuar në statistikat, në raportet dhe në procesverbalet e Komisionit.

(vijon në faqen 14)

Raport për veprimtarinë e Komisionit të Integritimit European Shtator – Nëntor 2011

(vijon nga faqja 13)

Qëllimet e këtij Komisioni ishin: (neni 3)

Nxitja e procesit të integritimit të Shqipërisë në Bashkimin European dhe zbatimi i paktit të stabilitetit;

Bashkërendimi ndërparlamentar i komisioneve të përhershme të Kuvendit për synimet e këtij Komisioni;

Koordinimi i politikave të Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të lidhura me MSA dhe me Paktin e Stabilitetit;

Përputhja e legjislacionit shqiptar me standartet dhe kërkesat e Bashkimit European;

Forcimi i bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë, Parlamentit European, Asambleve Parlamentare të KE-së dhe të OSBE-së për të ndikuar në nxitjen dhe zbatimin të Paktit të Stabilitetit dhe të përshpejtimit të procesit të Stabilizim Asocimit;

Krijimin e bërthamave parlamentare për parandalimin e konflikteve në rajon dhe shkëmbimin e informacioneve ndërmjet parlamenteve;

Forcimi i bashkëpunimit me parlamentet e rajonit, shkëmbimi i përvojave në procesin e Stabilizim Asocimit;

Plotësimi i kushteve dhe detyrimeve për hapjen e negociatave të MSA në fushën politike, ekonomike, të drejtësisë dhe të mjedisit;

Transparenca ndaj opinionit publik si dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile në zbatimin e procesit të integritimit european dhe të paktit të stabilitetit;

Organizimi i debateve parlamentare për rëndësinë e luftës kundër krimit të organizuar dhe të trafikut njerëzor, me qëllim mbajtjen e këtij problemi vazhdimisht në axhendën politike kombëtare;

Informimi i Kuvendit me politikën e demokracisë, sigurisë e të zhvillimit ekonomik në kuadër të paktit të stabilitetit dhe iniciativave të tjera rajonale, si SEECI, SEECIP, Adriatiko-Joniane etj.

Me miratimin e Rregullores² së re me vendim të Kuvendit, Komisioni Parlamentar për Integritimin European renditet i dyti në listen e tetë komisioneve të përhershme. Ky vendim i jep Komisionit një rëndësi të veçantë duke i përcaktuar edhe fushën e kompetencave të tij e cila është *integrimi në Bashkimin European*³. Në relacion me komisionin e mëparshëm është e nevojshme të konstatohet se, së pari, Komisioni me Rregulloren e re është komision i përhershëm dhe jo më i përkohshëm dhe, së dyti, si rrjedhojë e përhershmerisë së tij, ai merr një aspekt vazhdimësie. Në këtë mënyrë edhe Parlamenti është një tregues që integrimi european është një proces që ndërtohet

dita ditës. Kjo legjislaturë është e treta që Komisioni i Integritimit po përballet me integritimin european në mënyrë të vazhdueshme, natyrisht, duke marrë eksperiencë të çmuar edhe nga parlamentet e tjera. Gjithashtu, duke e konsideruar Shqipërinë si vend potencial kandidat, Komisioni i Integritimit European ka tashmë një eksperiencë të konsoliduar në këtë dhe puna e tij është gjithnjë në rritje. Pas ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA), Komisioni ka hyrë në një fazë të re dhe të rëndësishme të procesit të Integritimit European, sepse në fazën aktuale dhe në atë të kandidatit, Shqipëria jo vetëm duhet të tregojë një vullnet politik për rrugën e saj drejt Bashkimit European, por edhe zbatimin e të standardeve të cilat janë rrjedhojë direkte pas hyrjes në fuqi të MSA.

Kompetencat e këtij Komisioni, duke u bazuar në Rregulloren e Kuvendit, janë kryesisht tre: shqyrtimi i projektligjeve dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European; monitorimi i Qeverisë dhe i politikave në zbatim të ligjeve të përafuara për rritjen e standarteve europiane në Shqipëri, si dhe funksioni zgjedhor.

Funksioni ligjberës

Aktiviteti i Komisionit bazohet kryesisht në kalendarin e Kuvendit të Shqipërisë si dhe në Programin e punës së tij. Bazuar në këto dy dokumente, Komisioni për Integritimin European, gjatë periudhës shtator-nëntor 2011 ka zhvilluar disa mbledhje për shqyrtimin e projektligjeve për të cilin ka qenë komision për dhënie mendimi në lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European.

Shtator 2011

Gjatë muajit shtator Komisioni ka shqyrtuar 2 projektligje:

Projektligji “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji në fjalë është diskutuar në dy mbledhje të Komisionit të Integritimit.

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të kafshëve të tokës dhe të ujit; përcaktimi i procedurave për parandalimin, monitorimin, diagnostikimin, trajtimin dhe çrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve; mbrojtja e shëndetit publik nga sëmundjet zooteknike të transmetueshme nga kafshët, si dhe lëndët mbetëse të dëmshme, të cilat gjenden në produktet për konsum publik; sigurimi i zbatimit të masave shëndetësore veterinarë për produktet me origjinë shtazore të prodhuara në fermë, lëndët e papërpunuara, kullotat, ujin dhe vendet e pirjes së ujit për kafshët; mbrojtja e shëndetit riprodhues të kafshëve, sigurimi i rritjes së prodhimtarisë dhe përmirësimi racor; mbrojtja e mjedisit nga infeksionet, helmet, mbeturinat e kafshëve dhe ndotjet me pasojë dëmtuese për shëndetin e kafshëve dhe njerëzve: përcaktimi i procedurave të trajtimit

(vijon në faqen 15)

² Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e miratuar me vendim nr. 166, datë 16.12.2004 dhe e modifikuar me Vendim nr. 193, datë 07.07.2008, Vendim nr. 15, datë 27.12.2005, Vendim nr. 21, datë 04.03.2010, Vendim nr. 41, datë 24.06.2010, Vendim nr. 88 datë 24.02.2011, Vendim 89, datë 24.02.2011

³ Neni 19 i Rregullores së Kuvendit.

Raport për veprimtarinë e Komisionit të Integritimit Europian Shtator – Nëntor 2011

(vijon nga faqja 14)

dhe të informimit në fushën e veterinarisë për veterinerët, pronarët apo kujdestarët e fermave të kafshëve dhe publikun; mbrojtja e kafshëve nga tortura dhe sigurimi i mirëqënies së tyre; mbrojtja e kafshëve të egra; sigurimi i asgjësimit të sigurt të kafshëve të ngordhura, kadavrave, konfiskateve, mbeturinave të kafshëve dhe produkteve të tyre jo për konsum njerëzor; përcaktimi i detyrimeve të fermerëve, personave fizike apo juridike në zbatim të këtij ligji.

Projektligji është i përputhur pjesërisht me direktiven 82/894/KEE të Këshillit, datë 21 Dhjetor 1982, Direktivën e Këshillit 86/609/KEE, datë 24 Nëntor 1986, Direktivën 90/425/KEE të Këshillit, datë 26 Qershor 1990, Direktivën 91/496/KEE të Këshillit, datë 15 Korrik 1991, Direktivën 92/119/KEE të Këshillit, datë 17 Dhjetor 1992, Direktivën 93/119/KE të Këshillit, datë 22 Dhjetor 1993, Direktivën 96/23/KE e Këshillit, datë 29 Prill 1996, Direktivën 97/78/KE të Këshillit, datë 18 Dhjetor 1997, Direktivën 98/58/KE të Këshillit, datë 20 Korrik 1998, Direktivën 2001/82/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 6 Nëntor 2001, Direktivën 2002/32/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 7 Maj 2002, Direktivën 2002/99/KE të Këshillit, datë 16 Dhjetor 2002, Direktivën 2003/99/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 17 Nëntor 2003, Direktivën 2006/88/KE të Këshillit, datë 24 Tetor 2006, si dhe me Rregulloren 999/2001/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 Maj 2001, Rregulloren 178/2002/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 28 Janar 2002, Rregulloren 1831/2003/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Këshillit, datë 22 Shtator 2003, Rregulloren 21/2004/KE të Këshillit, datë 17 Dhjetor 2003, Rregulloren 853/2004/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 29 Prill 2004, Rregulloren 854/2004/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 29 Prill 2004, Rregulloren 882/2004/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 29 Prill 2004, Rregulloren 1/2005/KE të Këshillit, datë 22 Dhjetor 2004, Rregulloren 1198/2006/KE të Këshillit, datë 27 Korrik 2006, Rregulloren 834/2007/KE të Këshillit, datë 28 Qershor 2007, Rregulloren 834/2007/KE të Këshillit, datë 28 Qershor 2007, Rregulloren 1099/2009/KE të Këshillit, datë 24 Shtator 2009.

Komisioni ka paraqitur tre amendamente të cilat janë përfshirë në versionin përfundimtar pas miratimit në seancë plenare të projektligjit.

Gjatë prezantimit të projektligjit ishin të pranishëm nga Ministria e Integritimit një përgjegjës sektori dhe një specialist, të cilët kanë ndjekur procesin e përafrimit si dhe nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dy drejtorë drejtorie, një përgjegjës sektori, një specialist dhe një përfaqësues i një institucioni në vartësi të Ministrisë.

Projektligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Projektligji në fjalë është diskutuar në një mbledhje të Komisionit të Integritimit.

Qëllimi i tij është mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut si dhe sigurimi i duhur mjedisor i mbetjeve nëpërmjet parandalimit ose pakësimit të ndikimeve negative nga gjenerimi dhe menaxhimi i mbetjeve, pakësimi i ndikimeve të përgjithshme nga përdorimi i burimeve dhe përmirësimi i frytshmërisë së përdorimit të tyre.

Projektligji është i përputhur plotësisht me Direktivën 2008/98/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 Nëntor 2008, Direktivën 1999/31/KE e Këshillit, datë 26 Prill 1999, Rregullorja (KE) 1013/2006 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 14 Qershor 2006, Direktivën 1999/31/KE e Këshillit, datë 26 Prill 1999, Direktivën 2006/21/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 15 Mars 2006, Direktivën 2006/66/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 6 Shtator 2006, Direktivën 2002/96/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 27 Janar 2003, Direktivën 2000/53/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 18 Shtator 2000, Direktivën e Këshillit 1996/59/KE, datë 16 Shtator 1996, Direktivën 94/62/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 20 Dhjetor 1994, Direktivën e Këshillit 86/278/KEE, datë 12 qershor 1986.

Komisioni ka paraqitur një amendament, i cili është përfshirë në versionin përfundimtar pas miratimit në seancë plenare.

Gjatë prezantimit të projektligjit ishin të pranishëm nga Ministria e Integritimit një përgjegjës sektori dhe një specialist, të cilët kanë ndjekur procesin e përafrimit si dhe nga Ministria e Mjedisit, dy përgjegjës sektori dhe dy specialistë.

Tetor 2011

Gjatë muajit tetor Komisioni i Integritimit europian ka shqyrtuar 3 projektligje:

Projektligji “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”.

Projektligji në fjalë është diskutuar në një mbledhje të Komisionit të Integritimit.

Qëllimi i tij është kontrolli i ekspozimeve të publikut dhe të punonjësve, si dhe monitorimi rrezatimeve jojonizuese, duke shfrytëzuar të mirat që vijnë nga përdorimi i tyre.

Në këtë projektligj nuk janë parashikuar direktiva apo rregullore për t'u përafruar me legjislacionin europian. Projektligji është i përafruar në *frymë* me parimet e së drejtës Europiane.

Gjatë prezantimit të projektligjit ishin të pranishëm nga Ministria e Integritimit një specialist i cili ka ndjekur procesin e përafrimit si dhe nga Ministria e Shëndetësisë një drejtor drejtorie, dy përfaqësues nga institucionet në varësi dhe tre përfaqësues nga institucione jopublike.

Projektligji “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 9901, datë 14. 4. 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

(vijon në faqen 16)

Raport për veprimtarinë e Komisionit të Integritimit European Shtator – Nëntor 2011

(vijon nga faqja 15)

Projektligji në fjalë është diskutuar në një mbledhje të Komisionit të Integritimit.

Qëllimi i këtij projektligji është përafrimi i plotë i Ligjit Nr. 9901, datë 14. 4. 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare” me *Acquis* të BE-së.

Projektligji është i përputhur plotësisht me Direktivën e Dytë të Këshillit 77/91/KEE, datë 13 Dhjetor 1976.

Komisioni ka paraqitur tetë amendamente, të cilat janë përfshirë në versionin përfundimtar pas miratimit në seancë plenare.

Gjatë prezantimit të projektligjit ishin të pranishëm nga Ministria e Integritimit një përgjegjës sektori dhe një specialist të cilët kanë ndjekur procesin e përafrimit si dhe nga Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dy drejtor drejtorie.

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve”, iniciativë e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Projektligji në fjalë është diskutuar në një mbledhje të Komisionit të Integritimit.

Projektligji synon krijimin e mundësive për lëvizjen e lirë të ndërsjellë të shtetasve të të dy vendeve, bazuar në parimin e lëvizjes së lirë, një nga katër liritë themelore të Bashkimit European dhe ka si objekt kryesor lehtësimin dhe intensifikimin e kontakteve ndërmjet shtetasve të të dy vendeve. Kjo marrëveshje do të ndikojë pozitivisht në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve në të gjitha fushat

Ky projektligj është në përputhje të plotë me Nenet 3, 12, 13 dhe 14 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri, të cilat parashikojnë detyrimin e Republikës së Shqipërisë që të nxisë bashkëpunimin dhe Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit që kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me BE-në, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm koncesionesh të ndërsjella lidhur me lëvizjen e personave.

Gjatë prezantimit të projektligjit ishin të pranishëm nga Ministria e Integritimit një drejtor drejtorie, nga Ministria e Punëve të Jashtme një drejtor drejtorie dhe nga Ministria e Brendshme një drejtor drejtorie.

Nëntor 2011

Gjatë muajit nëntor Komisioni i Integritimit european ka shqyrtuar 4 projektligje:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9662, datë 18.02.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji në fjalë është diskutuar në dy mbledhje të Komisionit të Integritimit.

Qëllimi i tij është ripërkufizimi i veprimtarisë bankare, duke hequr të drejtën ekzkluzive të subjekteve bankare në

emëtimin e mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike. Ndryshimet në këtë projektligj synojnë hapjen e rrugës për ndryshimin e kuadrit rregullativ për instrumentat e pagesës elektronike duke mundësuar që emetimi i instrumentave elektronike të pagesave dhe të parasë elektronike të kryhet edhe nga subjektet financiare të cilat nuk janë banka.

Projektligji është i përputhur pjesërisht me Direktivën 2006/48/KE të Këshillit, datë 14 Qershor 2006, Direktivën 2009/110/KE të Këshillit, datë 14 Qershor 2006, Direktivën 2008/48/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 23 Prill 2008.

Gjatë prezantimit të projektligjit ishin të pranishëm nga Ministria e Integritimit një specialist i cili ka ndjekur procesin e përafrimit si dhe nga Ministria e Financave tre përfaqësues nga institucione në varësi të Ministrisë.

Projektligji “Për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve Joushqimore”.

Projektligji në fjalë është diskutuar në një mbledhje të Komisionit të Integritimit.

Qëllimi i tij është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të operatorëve ekonomikë sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të produkteve, në mënyrë që të garantojnë dhe të sigurojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore në lidhje me to.

Projektligji është i përputhur plotësisht me Direktivën 2001/95/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 3 Dhjetor 2001, Rregulloren 765/2008/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 9 Korrik 2008.

Komisioni ka paraqitur pesë amendamente të cilët janë përfshirë në version përfundimtar pas miratimit në seancë plenare.

Gjatë prezantimit të projektligjit ishin të pranishëm nga Ministria e Integritimit një specialist i cili ka ndjekur procesin dhe nga Ministrisë Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës një drejtor drejtorie dhe dy përgjegjës sektori.

Projektligji “Për Tregtimin dhe Mbikqyrjen e Tregut të Produkteve Joushqimore”.

Projektligji në fjalë është diskutuar në një mbledhje të Komisionit të Integritimit.

Qëllimi i tij është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të operatorëve ekonomike sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të produkteve, në mënyrë që të garantojnë dhe të sigurojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore në lidhje me to si dhe detyrimet e personave përgjegjës të disa produkteve, grup produktesh apo instalimesh kur janë vënë në shërbim.

Projektligji është i përputhur plotësisht me Vendimin Nr. 768/2008/KE dhe i pjesërisht me Rregulloren Nr.765/2008/KE.

Komisioni ka paraqitur katër amendamente të cilët janë përfshirë në version përfundimtar pas miratimit në seancë plenare.

(vijon në faqen 17)

Raport për veprimtarinë e Komisionit të Integrimit European Shtator – Nëntor 2011

(vijon nga faqja 16)

Gjatë prezantimit të projektligjit ishin të pranishëm nga Ministria e Integrimit një përgjegjës sektori dhe një specialist të cilët kanë ndjekur procesin e përafrimit të legjislacionit, si dhe nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës një drejtor drejtorie dhe një përgjegjës sektori.

Projektligji “Për Buxhetin e vitit 2012”.

Projektligji në fjalë është diskutuar në dy mbledhje të Komisionit të Integrimit.

Komisioni i Integrimit shqyrtoi projektbuxhetin për vitin 2012 duke u përqëndruar kryesisht në tre drejtime: Buxheti i Ministrisë së Integrimit dhe i Ministrive të linjës për mbështjetjen e procesit të integrimit; bashkëfinancimi i projekteve IPA ku Shqipëria merr pjesë me 15%; zbatimin e 12 prioritetëve të parapërcaktuara nga Komisioni European në dy raportet fundit të progresit Komisionit European për Shqipërinë.

Në mbledhjen e parë komisioni pasi zhvilloi një seancë dëgjimore me Ministren e Integrimit European, Znj. Bregu, miratoi projektbuxhetin në parim.

Në mbledhjen e dytë komisioni shqyrtoi projektbuxhetin nen për nen.

Në mbledhjen e dytë të komisionit ishin të pranishëm nga Ministria e Integrimit European, një specialist për buxhetin, dhe nga Ministria e Financave, një zëvendës ministër dhe një drejtor drejtorie. Pas shqyrtimit të këtij projektligji nen për nen, Komisioni e miratoi atë edhe në tërësi.

Funksioni mbikqyrës

Shtator

Seancë dëgjimore me Ministren e Integrimit European, Znj. Majlinda Bregu.

Komisioni i Integrimit European ka zhvilluar një seancë dëgjimore me Znj. Bregu, Ministre për Integrimin European mbi 12 rekomandimet e Komisionit European.

Në këtë takim kanë monitoruar takimin edhe 2 përfaqësues së shoqërisë civile.

Tetor

Komisioni për Integrimin European nuk ka zhvilluar asnjë seancë dëgjimore.

Nëntor

Seancë dëgjimore me Ministren e Integrimit European, Znj. Majlinda Bregu.

Komisioni i Integrimit European ka zhvilluar një seancë dëgjimore me Znj. Bregu, Ministre për Integrimin European mbi Buxhetin e shtetit 2012.

Përsa i përket funksionit mbikqyrës, Komisioni i Integrimit European ka kërkuar informacion si nga Ministria e Integrimit European, si dhe nga Ministrinë e linjës. Komisioni për Integrimin European ka ndjekur nga afër zbatimin e 12 rekomandimeve, duke i kërkuar informacion të vazhdueshëm Ministrisë së Integrimit mbi raportimin e saj në strukturat e Bashkimit European. Përgjigjet kanë qenë objekt shqyrtimi të përfaqësuesve politikë në Komisionin e Integrimit European.

Gjithashtu Komisioni për Integrimin European ka kërkuar informacion mbi kapitullin IV të MSA mbi lëvizjen e lirë të mallrave. I gjithë materiali është në shqyrtim nga anëtarët e Komisionit.

Në kuadër të mbikqyrjes parlamentare, Komisioni i Integrimit European ka kërkuar gjithnjë përfaqësues të Ministrisë së Integrimit, për sektor të ndryshëm të cilët kanë ndjekur nga afër përafrimin e legjislacionit dhe gjatë diskutimeve është kërkuar informacion nga ato për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe për kapacitetet që duhen ngritur për implementimin e standardeve europiane në legjislacionin e përafuar.

Gjithashtu Komisioni, gjatë shqyrtimit të projektligjeve, ka dhënë rekomandimet e veta për përfaqësues të ministrive të cilët janë përcjellur pranë dikastereve përkatëse.

Funksioni zgjedhor

Deri në këto momente Komisioni për Integrimin European nuk e ka ushtruar këtë funksion.

Bashkëpunoi: Denis Gila

Raport përmbledhës mbi veprimtarinë e Komisionit Parlamentar për Integrimin European dhe punimeve të Kuvendit në seancë plenare 6 tetor – 30 nëntor

Komisioni për Integrimin European 11 tetor – 30 nëntor

Nëpërmjet monitorimit të këtij Komisioni gjatë periudhës 11.10.2011 – 30.11.2011 janë mbledhur të dhënat e mëposhtme: Gjatë kësaj periudhe Komisioni ka zhvilluar

9 mbledhje, 8 prej të cilave kanë qenë të parashikuara në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Vetëm një mbledhje, ajo e datës 21.10.2011 nuk ka qenë e parashikuar në kalendar. Kjo mbledhje është zhvilluar me dyer të mbyllura,

(vijon në faqen 18)

Raport përmbledhës mbi veprimtarinë e Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian dhe punimeve të Kuvendit në seancë plenare 6 tetor – 30 nëntor

(vijon nga faqja 17)

në të cilën nuk janë lejuar të marrin pjesë mediat, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të interesuar të tjerë. Nga 8 mbledhjet që kanë qenë të parashikuara në kalendar Qendra e Studimeve Parlamentare ka monitoruar drejtpërsëdrejti 5 prej tyre dhe për 3 të tjera informacioni është marrë nga shqyrtimi i proces-verbaleve të publikuara në faqen e internetit të Kuvendit. Kjo ka ardhur si pasojë e mospajisjes së monitoruesit të QSP-së me lejen hyrëse nga personeli i administratës në Kuvend, përmendim përkatësisht mbledhjet e datave 18.10.2011, 15.11.2011 dhe 21.11.2011.

Ky Komision ka zhvilluar gjatë kësaj kohe afërsisht 438 minuta punë efektive, e përlllogaritur kjo në një mesatare prej 48 minutash për çdo mbledhje. Kohëzgjatja reale e mbledhjeve të Komisionit varion nga 20-110 minuta. Komisioni i zhvillon punimet kryesisht ditëve të marta të javës. Gjatë periudhës së monitoruar pesë mbledhje janë zhvilluar ditëve të marta, dy mbledhje ditëve të hëna, një mbledhje ditë të mërkurë dhe një tjetër ditë të premte (mbledhja me dyer të mbyllura).

Të gjithë projektligjet e shqyrtuara në mbledhjet e Komisionit kanë qenë të përfshirë në kalendarin tre-javor të punimeve të Kuvendit. Periudha e monitorimit mbulon respektivisht tre kalendarë tre-javorë punimesh të Kuvendit: 24.09.2011-16.10.2011; 17.10.2011-4.11.2011 dhe 7.11.2011-25.11.2011, si dhe është përfshirë edhe mbledhja e datës 30.11.2011 në rend dite të së cilës ka qenë projektbuxheti i vitit 2012.

Komisioni për Integrimin Europian gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë përgjegjës për asnjë projektligj të diskutuar. Ai ka dhënë vetëm mendime, ka bërë vërejtje dhe ka sugjeruar ndryshime tek komisioni përgjegjës i projektligjit të shqyrtuar, të cilët më së shumti kanë qenë: Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë; Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin; Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Gjatë kësaj periudhe janë bërë amendamente nga anëtarët e Komisionit, në total 12 të tillë, ku 8 i përkasin projektligjit “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 9901, datë 14. 4. 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe 4 projektligjit “Për Tregtimin dhe Mbikqyrjen e Tregut të Produkteve Joushqimore”.

Në çdo mbledhje të Komisionit gjatë kësaj periudhe kanë qenë të ftuar përfaqësues nga ministratë e linjës si psh: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (për projektligjin “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”), Ministria e Shëndetësisë (për projektligjin “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”), Ministria e Punëve të Jashtme (për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, për lëvizjen e ndërsjellë të Shtetasve”), etj. Gjithashtu, në çdo mbledhje të Komisionit janë të pranishëm edhe përfaqësues (specialistë) nga Ministria e Integritimit Europian.

Koha mesatare e fillimit të shqyrtimit të një projektligji në Komision, duke marrë parasysh datën e ardhjes së tij në Kuvend, llogaritet 40 ditë/projektligj.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur vetëm një seancë dëgjimore, mbledhja e datës 21.11.2011 ku në Komision ka qenë e ftuar Ministria e Integritimit Europian, znj. Majlinda Bregu, e cila prezantoi projektbuxhetin e vitit 2012 për Ministrinë që përfaqëson.

Ekspertiza e shfrytëzuar nga anëtarët e Komisionit është vetëm ajo e përfaqësuesve dhe specialistëve nga ministratë e linjës.

Pjesëmarrja e deputetëve anëtarë të Komisionit në mbledhje është e kënaqshme. Komisioni për Integrimin Europian ka në përbërje të tij 9 anëtarë. Nga këta 5 anëtarë janë të mazhorancës dhe 4 të opozitës. Kryetari i Komisionit është përfaqësues i partive të opozitës dhe nënkryetari nga partitë e mazhorancës parlamentare. Monitorimi i kryer tregon se kuorumi i zhvillimit të mbledhjeve të Komisionit është 8 deputetë/mbledhje me përjashtim të mbledhjes së datës 7.11.2011 kur kuorumi ishte vetëm 5 anëtarë. Në dy mbledhje të Komisionit kanë qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij, konkretisht në mbledhjet e datës 11.10.2011 dhe 25.10.2011.

Nga të dhënat e mbledhura prej evidencave të marra nga listë-përbërja e anëtarëve të komisioneve parlamentare në Kuvend rezulton se 3 nga 9 deputetët e këtij Komisioni janë anëtarë edhe në komisione të tjera parlamentare ç’ka përbën shpesh herë shkak të mospërputhjes së orareve të mbledhjeve duke sjellë vonesa në fillimin e saj dhe/ose mungesa të anëtarëve. Vonesat në fillimin e mbledhjeve llogariten 15 minuta/mbledhje nga orari i parashikuar për të filluar.

Edhe Komisioni i Integritimit Europian aplikon formulën e anëtarëve zëvendësues të tij. Dy është numri i deputetëve zëvendësues në Komision. Këto dy deputetë zëvendësues kanë marrë pjesë vetëm në mbledhjen e datës 25.10.2011. Një dukuri që nuk mungon edhe në këtë Komision janë rastet kur disa deputetë qëndrojnë vetëm disa minuta në mbledhje dhe më pas largohen ose vijnë vetëm në minutat e fundit të saj.

Shkalla e pjesëmarrjes së anëtarëve të Komisionit në diskutimet e projektligjeve është e kënaqshme. Kjo reflektohet nga pjesëmarrja e tyre në debate për aspekte të ndryshme të projektligjeve.

Media ka qenë e pranishme në të gjitha mbledhjet e Komisionit me përjashtim të mbledhjes së zhvilluar me dyer të mbyllura.

Në rendin e ditës së punimeve të Komisionit përfshihet kryesisht një projektligj për çdo mbledhje. Përjashtim bën mbledhja e datës 15.11.2011 ku u shqyrtuan dy projektligje. Asnjë projektligj nuk është shqyrtuar në më shumë se një mbledhje dhe vetëm një projektligj është shtyrë për rishqyrtim, projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9662, datë 18.02.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Kërkesa për të shtyrë diskutimin e këtij

(vijon në faqen 19)

Raport përmbledhës mbi veprimtarinë e Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian dhe punimeve të Kuvendit në seancë plenare 6 tetor – 30 nëntor

(vijon nga faja 18)

projektligji u kërkuar nga deputetët e opozitës me arsyetimin për të mbledhur më shumë informacione rreth tij, kërkesë e cila fillimisht nuk u pranua nga nënkryetarja e Komisionit e cila drejtonte mbledhjen. Kjo solli largimin e deputetëve të opozitës nga mbledhja dhe për mos plotësim të kuorumit të kërkuar, mbledhja u shty për një javë më pas.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi nuk është zhvilluar asnjë raportim në këtë Komision dhe asnjë raport kontrolli.

Punimet e Kuvendit në seancë plenare 6 tetor – 24 nëntor

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar gjithsej 8 seanca plenare në Kuvendin e Shqipërisë, të gjitha të parashikuara në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Periudha e monitorimit mbulon respektivisht tre kalendarë tre-javorë punimesh të Kuvendit: 24.09.2011-16.10.2011; 17.10.2011-4.11.2011 dhe 7.11.2011-25.11.2011. Nga 8 seancat plenare të zhvilluara Qendra e Studimeve Parlamentare ka monitoruar drejtpërsëdrejti 7 seanca plenare, pasi seanca e datës 6.11.2011 nuk u bë e mundur të ndiqej për arsye të mospajisjes me leje hyrëse nga administrata e Kuvendit. Në informacionet e dhëna në vijim mungon ai për këtë seancë pasi edhe procesverbali i kësaj seance nuk është bërë ende publik në faqen e internetit të Kuvendit.

Nga monitorimi rezulton se rendi i ditës së seancave plenare ka ndryshime në përmbajtje nga ai i parashikuar në kalendarin tre-javor të punimeve për seancat plenare. Ka projektligje që nuk përfshihen në rendin e ditës të seancës plenare sikurse ka edhe një rast kur në rend dite është futur diskutimi i një projektligji i paparashikuar në kalendar, përmendim këtu Dekretin nr. 7122 datë 14.10.2011 “Për rikthimin për rishqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë të Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”” (njohur si ligji i plehrave), në seancën plenare të datës 3.11.2011.

Shembuj të projektligjeve të shqyrtuara në seancë por që nuk përputhen me parashikimin e bërë në kalendar përmenden: projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9662, datë 18.02.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë””, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10.253, datë 01.03.2010 “Për gjuetinë”, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në RSH” të ndryshuar”, “Për një ndryshim në ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” të ndryshuar”, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar”.

Në të gjitha rastet rendi i ditës i seancës plenare bëhet i ditur në momentin e fillimit të seancës nga Kryetari i

Kuvendit që drejton edhe seancën, pasi mungon publikimi i tij paraprak për median dhe të tjerë të interesuar.

Seancat plenare të Kuvendit zhvillohen çdo ditë të enjte të javës në orën 10⁰⁰. Nga monitorimi i kryer nga QSP rezulton se asnjë seancë plenare nuk ka filluar në orarin e parashikuar. Vonesat variojnë nga 20-90 minuta.

Kohëzgjatja e një seance plenare varion nga 240-480 minuta. Përrjashtim ka bërë seanca plenare e datës 24.11.2011 ku është shqyrtuar projektligji për projektbuxhetin e shtetit të vitit 2012, diskutimi dhe miratimi në parim i tij, seancë e cila është zhvilluar deri në orët e vona të natës për të vijuar edhe në ditën tjetër, në datë 25.11.2011.

Në rendin e ditës së një seance plenare sipas kalendarit tre-javor të punimeve janë parashikuar 6-7 projektligje për shqyrtim. Në total gjatë kësaj periudhe janë miratuar 18 projektligje dhe dy projektvendime, disa prej të cilëve kanë kaluar për shqyrtim edhe në Komisionin e Integritimit Europian si psh: projektligjet “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9662, datë 18.02.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore” etj.

Projektligjet e miratuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit janë votuar me një shumicë mesatare prej 114 vota pro me përjashtim të tre projektligjeve, (priligi “i plehrave”, i profesioneve të rregulluara dhe projektbuxheti i vitit 2012) që janë miratuar vetëm me 70-71 vota pro.

Projektligjet diskutohen dhe miratohen në të gjitha rastet gjatë një seance të vetme plenare.

Koha e kushtuar për një projektligj nga deputetët në seancë llogaritet mesatarisht 60min/projektligj. Për projektligje të veçanta diskutimi ka zgjatur deri në 320 minuta siç përmendet rasti i projektligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, kthyer me dekret të Presidentit të Republikës apo projektligji “Për buxhetin e vitit 2012”.

Projektligjet që kërkojnë një shumicë të cilësuar votash për t’u miratuar vazhdojnë të shtyhen në Kuvendin e Shqipërisë, edhe pse ata kanë qenë vazhdimisht të parashikuar në kalendarët tre-javorë të punimeve, ku përmendim: projektligjet “Për gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative dhe Organizimin e Drejtësisë Administrative”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” etj, projektligje për të cilat kërkohet konsensusi politik. Të vetmet projektligje që janë miratuar gjatë kësaj periudhe me shumicë të cilësuar votash përmenden ato “Për një shtesë në ligjin nr. 10.040 datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, “Për

(vijon në faqen 20)

Raport përmbledhës mbi veprimtarinë e Komisionit Parlamentar për Integrimin Europian dhe punimeve të Kuvendit në seancë plenare 6 tetor – 30 nëntor

(vijon nga faqja 19)

disa ndryshime në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Krugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

Në asnjë rast nuk janë vënë re amendamente të bëra nga deputetët në seancë.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 2 interpelanca nga 4 të parashikuara. Interpelancat e zhvilluara ishin ato me Ministrin e Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit kërkuar nga deputeti Taulant Balla dhe interpelanca me Ministrin e Brendshëm kërkuar nga deputeti Gazmir Bizhga. Interpelancat e parashikuara me Ministrin e Punëve të Jashtme kërkuar nga deputetja Arta Dade dhe ajo me Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe

Energjetikës kërkuar nga deputeti Eduard Shalsi nuk janë zhvilluar edhe pse të parashikuara në kalendarin e punimeve të Kuvendit.

Pjesëmarrja mesatare e deputetëve në seancë plenare është 127 pjesëmarrës për seancë. Deputetët nuk janë “ndjekës” të rregullt të punimeve në seancë, ata largohen gjatë saj, vijnë me vonesë, etj. Fundi i punimeve të Kuvendit në seancë e gjen sallën e Kuvendit pothuajse bosh. Nga monitorimi evidentohet dhe një mungesë serioziteti për të dëgjuar dhe ndjekur kolegët e tyre deputetë gjatë diskutimeve. Ka plot raste kur deputetët flasin dhe bëjnë ndërhyrje pa mikrofon.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi nuk është zhvilluar asnjë seancë pyetjesh me ministra dhe titullarë të institucioneve publike kushtetuese.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi nuk është zhvilluar asnjë raportim nga titullarë institucionesh që kanë detyrimin të raportojnë në Kuvend.

K A L E N D A R I

(vijon nga faqja 1)

3. Projektligj “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë ‘Albpetrol’ sh.a. Patos”.

4. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë” të ndryshuar”.

5. Projektligj “Për një shtesë në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore” të ndryshuar”.

6. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në RSH” të ndryshuar”.

7. Plotësimi i vendeve vakante në institucione.

8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).

- SEANCË PLENARE -

E enjte, datë 22 dhjetor 2011, ora 10.00.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare.

2. Projektligj “Për ratifikimin e konventës rajonale për rregullat preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të origjinës”.

3. Projektligj “Për ratifikimin e Protokollit të Privilegjeve dhe imuniteteve të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore”

4. Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e Konventës për krijimin e

Këshillit të Bashkëpunimit Doganor, bërë në Bruksel më 15 dhjetor 1950”

5. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8951, datë 10.10.2002 “Për numrin e identitetit të shtetasve”.

6. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10.129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”.

7. Projektligj “Për mbikëqyrjen elektronike në fushën penale”

8. Projektligje “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” të ndryshuar’. (2 variante)

9. Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë të privatizimit) dhe të dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995” të ndryshuar”.

10. Plotësimi i vendeve vakante në institucione.

11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).

Veprimtari në Komisionet e Përhershme Parlamentare:

1. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë” të ndryshuar”.

Paraqitur nga KM më 24.10.2011 *vijon nga faqja*

(vijon në faqen 21)

KALENDARI

(vijon nga faqja 20)

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (përgjegjës)**

2. Projektligj “Për ratifikimin e konventës rajonale për rregullat preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të origjinës”.

Paraqitur nga KM, më 27.10.2011

· **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (përgjegjës)**

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

· **Komisioni për Politikën e Jashtme**

· **Komisioni për Integrimin European**

3. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8951, datë 10.10.2002 “Për numrin e identitetit të shtetasve”.

Paraqitur nga KM, më 08.11.2011

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (përgjegjës)**

4. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10.129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”.

Paraqitur nga KM, më 08.11.2011

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (përgjegjës)**

5. Projektligj “Për një shtesë në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore” të ndryshuar”.

Paraqitur nga KM, më 09.11.2011

· **Komisioni për Ekonominë dhe Financat (përgjegjës)**

· **Komisioni për Integrimin European**

6. Projektligj “Për transmetimet me zë dhe/ose me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë”.

Paraqitur nga grup deputetësh më 9.2.2011

· **Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (përgjegjës)**

· **Komisioni për Integrimin European**

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

7. Projektligje “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” të ndryshuar”.

Paraqitur nga një grup deputetësh më 03.10.2011 dhe 17.10.2011

· **Komisioni për Ekonominë dhe Financat (përgjegjës)**

· **Komisioni për Integrimin European**

8. Projektligj “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë ‘Albpetrol’ sh.a. Patos”.

Paraqitur nga KM, më 31.10.2011

· **Komisioni për Ekonominë dhe Financat (përgjegjës)**

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

9. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në RSH” të ndryshuar”.

Paraqitur nga deputet, më 03.10.2011

· **Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (përgjegjës)**

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

10. Projektligj “Për mbikëqyrjen elektronike në fushën penale”.

Paraqitur nga KM, më 17.11.2011

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (përgjegjës)**

· **Komisioni për Sigurinë Kombëtare**

· **Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

11. Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë të privatizimit) dhe të dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995” të ndryshuar”.

Paraqitur nga KM, më 17.11.2011

· **Komisioni për Ekonominë dhe Financat (përgjegjës)**

12. Projektligj “Për ratifikimin e Protokollit të Privilegjeve dhe imuniteteve të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore”

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (përgjegjës)**

· **Komisioni për Politikën e Jashtme**

13. Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e Konventës për krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor, bërë në Bruksel më 15 dhjetor 1950.

· **Komisioni për Ekonominë dhe Financat (përgjegjës)**

· **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

· **Komisioni për Politikën e Jashtme**

14. Shqyrtimi i kandidatave për vendet vakante në institucione. (Shqyrtimi në seancë plenare sapo komisioni përgjegjës të shprehet me anë të raportit në bazë të nenit 111 të Rregullores).

15. Interpelancë me Ministrin e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve kërkuar nga deputeti Erjon Braçe.

Interpelancë me Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës kërkuar nga deputeti Erjon Braçe.

Bashkëpunëtorë: Erion Fejzulla
Aida Gugu
Denis Gila
Taulant Troshani

Stafi i Projektit: Elira Zaka
Rovena Pregja
Kreshnik Loka

Qendra e Studimeve Parlamentare
Rr. Zef Jubani, Pall. Bjorn, nr. 5
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 44 80 8859;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org